



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.97

2004

17 dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9308 datë 4.11.2004	Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar.....	6603
Vendim i Kuvendit nr.165, datë 6.12.2004	Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).....	6631
Vendim i KM nr.808, datë 5.11.2004	Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre.....	6632
Vendim i KM nr.809, datë 26.11.2004	Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore.....	6634
Vendim i KM nr.814, datë 3.12.2004	Për normat e strehimit për familjet, që përfitojnë nga programet sociale të strehimit.....	6638
Vendim i KM nr.816, datë 3.12.2004	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë, për mbështetjen e projektit të shërbimeve efikente të punësimit në Shqipëri.....	6639
	Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i rrugës së varrezave të reja në qytetin e Shijakut”.....	6643

Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Shijakut”	6644
Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të pasurisë të paluajtshme, pronë private (tokë truall) të objektit “Ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Kukësit”	6644
Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i varrezave publike të bashkisë Kamëz”	6644
Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i ujësjellësit të ri të qytetit të Gjirokastrës”	6645
Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i ujësjellësit të ri në qytetin e Korçës”	6646

LIGJ
Nr.9308, datë 4.11.2004
PËR SHËRBIMIN DHE INSPEKTORATIN VETERINAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe financimin e shërbimit dhe inspektimit veterinar, si dhe të drejtat e detyrat e Administratës Veterinare.

Neni 2

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të mbrojë dhe të përmirësojë shëndetin e kafshëve nga sëmundjet ngjitëse;
- b) të përcaktojë procedurat për monitorimin, identifikimin, diagnostikimin, parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve të kafshëve;
- c) të mbrojë shëndetin publik nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët dhe prodhimet e tyre, nga lëndët mbetëse të dëmshme në produktet që përdoren për konsum publik;
- ç) të sigurojë zbatimin e masave sanitaro-veterinare për produktet me origjinë shtazore, për lëndët e papërpunuara, si dhe për ushqimet, kullotat e ujin për kafshët;
- d) të mbrojë shëndetin riprodhues të kafshëve, të sigurojë rritjen e prodhimtarisë dhe përmirësimin racor;
- dh) të mbrojë mjedisin nga infeksionet, helmet dhe ndotjet me pasoja dëmtuese për kafshët dhe njerëzit;
- e) të përcaktojë procedurat e trajnimit dhe të informimit në mjekësinë veterinare për specialistët veterinerë, pronarët ose kujdestarët e kafshëve dhe publikun;
- ë) të mbrojë kafshët nga tortura dhe të sigurojë mirëqenien e tyre;
- f) të mbrojë faunën dhe akuakulturën.

Neni 3

Për qëllimet e këtij ligji, termat e përdorur në të kanë këtë kuptim:

1. “Mjekësi veterinare” është fusha e shkencës dhe praktikës, që merret me kujdesin dhe mbrojtjen e kafshëve, parandalimin e sëmundjeve të tyre dhe përhapjen e zoonozave, diagnostikimin dhe mjekimin e kafshëve të sëmura, kontrollin e prodhimit dhe përpunimit të produkteve me origjinë shtazore, prodhimin dhe përdorimin e barnave veterinare, të preparateve biologjike, si dhe mbrojtjen e territorit të Republikës së Shqipërisë nga hyrja e sëmundjeve ngjitëse të kafshëve.
2. “Mjek veteriner” është veterineri i diplomuar në mjekësi veterinare, i cili ka një licencë veterinare për të ushtruar profesionin e mjekut veteriner.
3. “Licencë veterinare” është leja për kryerjen e veprimtarisë veterinare, dhënë sipas këtij ligji.

4. “Veprimtari veterinar” është veprimtaria e një mjeku veterinar të licencuar, që përfshin ekzaminimin e gjendjes shëndetësore të kafshës, vendosjen e diagnozës, ndërhyrje parandaluese dhe mjekuese, përshkrimin e barnave për kafshët, inspektimin sanitaro-veterinar të produkteve me origjinë shtazore, veprimtari këshillimore dhe veprimtari administrative veterinar.

5. “Teknik veterinar” është veterineri me arsim të mesëm profesional, i cili kryen disa detyra veterinarë nën kontrollin e një mjeku veterinar.

6. “Autoriteti kompetent qendror” është Drejtoria Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

7. “Autoriteti kompetent vendor” është sektori veterinar i qarkut.

8. “Kafshë” janë njëthundrakët (kuaj, gomarë, mushka), dythundrakët (gjedhet, buajt, dhentë, dhitë dhe derrat), shpendët (pulat, rosat, patat, gjelat e detit, struci dhe pëllumbat), qentë, macet, lepujt, kafshët e shpendët dekorative dhe ekzotike, bletët, krimbi i mëndafshit, peshqit, krustacet, molusqet, bretkocat, gjarpërinjtë, kafshët e gjahut të rritura në fermë, kafshët që përdoren për eksperimente, si dhe kafshët e egra.

9. “Pronari ose kujdestari i kafshëve” është personi fizik ose juridik, pronar i këtyre kafshëve ose persona të tjerë, që angazhohen në mbrojtjen, përdorimin, punën racore, ruajtjen, stërvitjen, transportimin dhe shitjen e kafshëve.

10. “Produkte me origjinë nga kafshët” janë përbërës nga pjesë të trupit të kafshëve të papërpunuara, gjysmë të përpunuara ose të përpunuara, si dhe qumështi, vezët, produktet e mishit, produktet e peshkut, produktet e qumështit dhe vezëve, mjalti dhe produkte të tjera nga bletët, produktet e peshkut, midhjeve, gjarpërinjve dhe bretkocave për konsum nga njerëzit, si dhe sperma e kafshëve, ovulat dhe embrionet.

11. “Materialet e papërpunuara me origjinë nga kafshët” janë përbërës të pjesëve të trupit të kafshës, si karkasat e kafshëve dhe të gjitha pjesët përbërëse të karkasave në gjendje të papërpunuar.

12. “Mbeturina me origjinë nga kafshët” janë përbërës të pjesëve të trupit të kafshës, mbeturinat e nënprodukteve dhe materialet e padobishme me origjinë shtazore, që nuk mund të përdoren për konsum publik.

13. “Ujëra të përljera” janë ujërat me origjinë nga stabilimentet e rritjes së kafshëve, thertore, si dhe stabilimente të tjera, të cilat kërkojnë drenazhim të veçantë dhe teknologji trajtimi.

14. “Ushqime të thjeshta, ushqime të përziera kafshësh dhe aditive” janë materiale që përdoren për ushqimin e kafshëve dhe që kërkojnë një certifikatë veterinarë.

15. “Mbetje” janë substanca të dëmshme me veprimtari farmakologjike, ndotëse të mjedisit, barna, hormone stimuluese me veti biologjike aktive të përdorura në veterinar, si dhe sasia totale e zbrëthimeve të tyre, të cilat mund të hyjnë në ushqimet me origjinë shtazore dhe në kafshën e gjallë dhe të rrezikojnë shëndetin publik.

16. “Ekskrecione dhe sekrecione” janë jashtëqitjet, urina dhe pështyma.

17. “Zoonozat” janë sëmundje ose infeksione, të cilat në rrugë natyrore mund të kalojnë nga kafshët te njerëzit dhe anasjelltas.

18. “Epizootia e një sëmundjeje ngjitëse” është një numër më i madh rastesh të një sëmundjeje ngjitëse, e cila, sipas frekuencës, kohës, vendit dhe llojit të kafshës së prekur, tejkalon numrin e mëparshëm të rasteve.

19. “Zonë e infektuar” është një zonë ku ka shpërthyer një ose disa burime të infeksionit, si dhe ekzistojnë kushte për përhapjen e mëtejshme të tij.

20. “Zonë në rrezik infeksioni” është një zonë ku një sëmundje nga një zonë e infektuar mund të përhapet në të.

21. “Inspektim dhe kontroll sanitaro-veterinar” është ekzaminimi dhe mbikëqyrja e kafshëve, e materialeve të papërpunuara, e produkteve me origjinë shtazore, e produkteve për kafshë dhe e mbeturinave:

a) për të siguruar mbrojtjen e publikut dhe të kafshëve nga sëmundjet ngjitëse të kafshëve;

b) për të parandaluar tregtimin e materialeve të papërpunuara dhe të produkteve me origjinë nga kafshët, të cilat nga ana sanitaro-veterinare janë të papërshtatshme;

c) për të mbikëqyrur stabilimentet ose mallrat, të cilat mund të jenë vektorë potencialë të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në kafshë.

22. “Sëmundjet ngjitëse të Listës së Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive (OIE)” janë sëmundje ngjitëse me rrezikshmëri të lartë përhapjeje, që nuk njohin kufij shtetërorë, që kanë pasoja serioze për shëndetin publik dhe pasoja social-ekonomike dhe me rëndësi të veçantë në tregun ndërkombëtar të kafshëve dhe të produkteve me origjinë nga kafshët, të përcaktuara në kodin zoosanitar ndërkombëtar të OIE-së.

23. “Konsum shtëpiak privat i produkteve me origjinë nga kafshët” është konsumi i produkteve me origjinë nga kafshët për nevojat familjare të pronarit ose kujdestarit të kafshëve.

24. “Therje emergjente e kafshëve” është therja e kafshëve pa kontroll veterinar paraprak, që lejohet vetëm në raste të caktuara me ligj.

25. “Therje e kafshëve të sëmura” është therja e kafshëve të sëmura nga sëmundje, për të cilat lejohet therja me ligj.

26. “Stallë me kushte epizootike të paverifikuara” është stalla e pronarit ose e kujdestarit të kafshëve, në të cilën nuk janë bërë ekzaminimet përkatëse dhe inspektimi sanitaro-veterinar nga autoriteti kompetent dhe që është përfshirë në tregti të paligjshme kafshësh dhe ushqimesh me origjinë prej tyre.

27. “Produkt mjekësor veterinar” është çdo substancë e përdorur për ekzaminim, që influencon në gjendjen fiziologjike dhe patologjike të kafshës së gjallë, substancat diagnostike veterinare, vaksinat veterinare, produktet veterinare mjekuese, suplementet joushqyese, ksenobiotikët, produkte mjekësore kryesore ose ndihmëse.

28. “Administrata Veterinare” është shërbimi veterinar shtetëror që ka kompetencë në të gjithë vendin për të vendosur masat sanitaro-veterinare, si dhe procedurat e certifikimit veterinar ndërkombëtar dhe kombëtar, sipas rekomandimeve të OIE-së e BE-së, si dhe kontrollon e inspekton zbatimin e tyre.

29. “Stacion karantine” është një instalim i vendosur nën kontrollin e autoritetit veterinar vendor ku mbahet në izolim një grup kafshësh, pa kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me kafshët e tjera, me qëllim që të kontrollohen gjatë një periudhe kohe të caktuar.

30. “Konsum publik” është konsumi i drejtpërdrejtë nga popullsia i prodhimeve ushqimore me origjinë nga kafshët.

31. “Produkt i sigurt me origjinë nga kafshët” është produkti që plotëson standardet ose kushtet që përcaktohen nga ligji veterinar, në të cilin përfshihet parandalimi dhe eliminimi i efekteve negative që ato shkaktojnë.

32. “Qendër inseminimi artificial” është një instalim për prodhimin dhe shpërndarjen e materialit biologjik (sperma, ovula dhe embrione), që plotëson kushtet sanitaro-veterinare.

33. “Bllokim” është masa e përkohshme e marrë nga autoriteti veterinar kompetent në rast shkeljeje, sipas këtij ligji, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

34. “Stabiliment” është çdo mjedis i miratuar dhe i regjistruar nga autoriteti kompetent veterinar, në të cilin mbahen dhe trajtohen kafshë, prodhohen dhe përpunohen produkte me origjinë shtazore.

35. “Thertore” është stabilimenti i miratuar nga autoriteti veterinar vendor, që përdoret për therjen e kafshëve të destinuara për konsum njerëzor dhe konsum kafshësh.

36. “Stalla” është ndërtesa dhe infrastruktura e nevojshme për mbarështimin e kafshëve.

37. “Ngarkesë” janë kafshët, produktet me origjinë nga kafshët, të destinuara për konsum njerëzor, për ushqim kafshësh, për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, për përdorim agroindustrial, spermë, embrione, vezë, produkte biologjike dhe material patologjik.

38. “Matrikullim” është vendosja e numrit individual, sipas një kodi të miratuar nga autoriteti kompetent qendror, për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale.

39. “Identifikimi i kafshëve dhe regjistrimi i fermave blegtorale” janë elementet e mëposhtme:

- a) kodi i regjistrimit të fermave blegtorale;
- b) matrikujt për identifikimin individual të kafshëve;
- c) baza informatike e të dhënave;
- ç) kartelat individuale të kafshëve;
- d) regjistri i fermës blegtorale.

40. “Njësi epidemiologjike” është njësia blegtorale, shtrirja territoriale e së cilës përcaktohet nga autoriteti kompetent.

KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E SHTETIT, TË PRONARËVE DHE PERSONAVE TË TJERË

Neni 4

1. Detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me parandalimin dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitëse në kafshë, si dhe tregtinë ndërkombëtare të kafshëve, materialeve të papërpunuara, produkteve me origjinë nga kafshët, ushqimeve për kafshë, biopreparateve dhe medikamenteve veterinarë, mbeturinave të kafshëve, vektorëve të sëmundjeve ngjitëse rregullohen në përputhje me konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

2. Përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë informojnë Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit për çdo shpërthim vatre sëmundjeve ngjitëse të deklaruar në vendet ku janë të akredituara.

Neni 5

1. Në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, mbrojtja kundër sëmundjeve ngjitëse në kafshë është detyrë e shtetit dhe e organeve të tij, shërbimit veterinar, pronarëve ose kujdestarëve të kafshëve, të produkteve me origjinë shtazore, të materialeve të papërpunuara dhe mbeturinave, të stabilimenteve prodhuese e përpunuese, si dhe e personave që merren me trajtimin, transportin, tregtimin dhe magazinimin e produkteve me origjinë shtazore, të materialeve të papërpunuara, mbeturinave dhe produkteve për kafshë.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoria Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, sektorët veterinarë në qarqe, zyrat veterinarë në bashki dhe komuna dhe shërbimi veterinar privat janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit veterinar.

Neni 6

1. Çdo pronar ose kujdestar i kafshëve ka të drejtë të zgjedhë lirisht mjekun veterinar. Bëjnë përjashtim rastet që kanë lidhje me mbrojtjen e detyrueshme të kafshëve kundër sëmundjeve ngjitëse.

2. Çdo pronar ose kujdestar i kafshëve është i detyruar:

a) të mbrojë shëndetin e kafshëve;

b) të mbrojë shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve nga sëmundjet zoonotike;

c) të ndihmojë në inspektimin dhe kontrollin sanitaro-veterinar, si dhe t'i japë veterinerit materiale për ekzaminim dhe të marrë masa të tjera për mbrojtjen kundër sëmundjeve ngjitëse të kafshëve të përcaktuara në këtë ligj;

ç) të lajmërojë veterinerin më të afërt në rast rreziku për shëndetin e kafshëve dhe të njerëzve;

d) t'i komunikojë autoritetit kompetent veterinar të dhëna për shëndetin e kafshëve dhe masat veterinarë dhe të lejojë këto autoritete që të verifikojnë besueshmërinë e këtyre të dhënave;

dh) të mos përdorë për qëllime të rritjes së peshës ose të riprodhimit ndonjë substancë me përmbajtje hormonale, e përcaktuar si e tillë në aktet nënligjore dhe ndonjë substancë të dëmshme për shëndetin e njeriut.

3. Me kërkesë të veterinerit shtetëror, pronari ose kujdestari i kafshëve është i detyruar të lejojë kontrollin dhe inspektimin e kafshëve, të strehimeve dhe të stabilimenteve.

4. Pronari ose kujdestari i kafshës, që mbarështon kafshë, ushtron veprimtarinë për prodhimin, përpunimin, magazinimin ose shitjen e produkteve me origjinë shtazore. Ai merret me punën racore të kafshëve shtëpiake dhe të egra dhe është i detyruar të regjistrojë kafshën, stabilimentet, pajisjet e tyre, si dhe të raportojë brenda 10 ditëve pranë zyrës veterinare të qarkut çdo ndryshim të kryer.

KREU III ORGANIZIMI I SHËRBIMIT VETERINAR

Neni 7

1. Shërbimi veterinar në Republikën e Shqipërisë kryen veprimtari veterinare me funksion të dyfishtë shërbimi dhe inspektimi për:

- a) shëndetin e kafshëve;
- b) mirëqenien e kafshëve;
- c) kontrollin e produkteve mjekësore veterinare;
- ç) marrëdhëniet ndërkombëtare në fushën e veterinarisë.

2. Veprimtaritë veterinare realizohen nga shërbimi veterinar shtetëror dhe privat, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 8

1. Shërbimi veterinar shtetëror organizohet si sistem i njësuar dhe mbulon të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai është i organizuar dhe vepron në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, në nivel qarku, bashkie dhe komune.

2. Shërbimi veterinar shtetëror integron në sistem edhe institucione të tjera ku ka veprimtari veterinare, përfshirë edhe Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Rendit Publik. Zyrat veterinare në këto ministri detyrohen të japin informacion zyrtar mujor, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Drejtoria Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit për problematikën dhe situatën veterinare.

3. Shërbimi veterinar shtetëror është pjesë përbërëse e rrjetit veterinar ndërkombëtar e rajonal, që bashkëpunon me organet homologe të Bashkimit Europian dhe të vendeve të tjera, me Zyrën Ndërkombëtare të Epizootive dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë në fushën përkatëse, si FAO e OBSH dhe me të gjitha vendet me të cilat ka marrëveshje dypalëshe.

Neni 9

1. Drejtoria e Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit është autoriteti kompetent qendror që mbulon veprimtarinë veterinare në shkallë vendi.

2. Sektori veterinar në qark është pjesë përbërëse e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit që mbulon veprimtaritë veterinare rajonale. Në përbërje të sektorit veterinar janë:

- a) inspektorë të shëndetit të kafshëve, të identifikimit, të epidemiologjisë dhe të riprodhimit;
- b) inspektorë të shëndetit publik veterinar;
- c) inspektorë të pikave të inspektimit veterinar kufitar;
- ç) shërbimi veterinar laboratorik.

3. Zyra veterinare vendore mbulon veprimtaritë veterinare në bashki dhe komuna, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe është në varësi teknike të sektorit veterinar të qarkut.

4. Shërbimi veterinar privat përbëhet nga:

- a) veterinerët privatë me kontratë me shtetin;
- b) veterinerët në profesion të lirë, klinikat veterinare, farmacitë veterinare, laboratorët veterinarë, stacionet e inseminimit artificial dhe spitalet veterinare;

c) veterinerët që punojnë në stabilimentet blegtorale, të kafshëve të ujit dhe grumbullim-përpunimit të produkteve me origjinë nga kafshët.

Neni 10

1. Drejtori i Drejtorisë Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit është njëkohësisht Kryeinspektori Veterinar Shtetëror në Republikën e Shqipërisë. Specialistët veterinarë të kësaj drejtorie në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit janë njëkohësisht inspektorë veterinarë.

2. Përgjegjësi i sektorit veterinar të qarkut është njëkohësisht kryeinspektor shtetëror veterinar i qarkut. Specialistët veterinarë shtetërorë në bashki e komunë janë në varësi teknike të tij dhe njëkohësisht inspektorë veterinarë.

KREU IV KOMPETENCAT E ADMINISTRATËS VETERINARE DHE BASHKËPUNIMI ME POLICINË

Neni 11

Drejtoria Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit ka këto kompetenca:

a) harton politikat veterinarë, programet e parandalimit, kontrollit dhe eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve ngjitëse në kafshë;

b) harton strategjitë afatshkurtra, afatmesme e afatgjata të veprimtarive veterinarë;

c) propozon përmirësimin e legjislacionit veterinar, duke e përafruar dhe përshtatur atë me legjislacionin e Bashkimit Europian;

ç) monitoron, së bashku dhe në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Veterinare, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga OIE-ja, situatën epizootike të sëmundjeve ngjitëse në kafshë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, si dhe informon për këtë qëllim shërbimin veterinar dhe qendrat e mbarështimit të kafshëve;

d) përshtat programe, koordinon punën dhe përcakton masat për zbatimin e programeve në lidhje me kontrollin dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në kafshë;

dh) harton raporte mujore për ecurinë e sëmundjeve ngjitëse të kafshëve në vend, informon palët e ineteresuara në vend për situatën e sëmundjeve ngjitëse dhe masat e ndërmarra dhe ia paraqet raportet përkatëse OIE-së;

e) mbikëqyr zbatimin e akteve ligjore e nënligjore veterinarë;

ë) mbikëqyr veprimtarinë administrative të zbatimit të këtij ligji dhe të rregulloreve të tjera në lidhje me veprimtarinë veterinarë;

f) menaxhon mjetet financiare për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, shëndetit publik dhe trajnimet e specialistëve;

g) mban një rezervë të detyrueshme vjetore mjetesh financiare për vaksina dhe bioprodukte për raste të domosdoshme dhe emergjente për luftimin e sëmundjeve ngjitëse në kafshë dhe zoonozat.

Neni 12

1. Policia e Shtetit detyrohet që t'i japë strukturave të shërbimit dhe Inspektoratit Veterinar ndihmën e nevojshme, sa herë kërkohet, për zbatimin e këtij ligji.

2. Kur gjatë kryerjes së detyrës, Policia e Shtetit ose ajo bashkiake zbulon që pronari ose kujdestari i kafshëve nuk ka certifikatë veterinarë për kafshët dhe produktet me origjinë shtazore gjatë transportit, i bllokoi ato menjëherë dhe informon Inspektoratin Veterinar.

Neni 13

Kur Policia e Shtetit ose ajo bashkiake zbulon që masat për mbrojtjen e mjedisit, sipas këtij ligji, nuk janë zbatuar, informon inspektoratin veterinar më të afërt.

Neni 14

Me kërkesën e inspektorit veterinar në zonat e infektuara, Policia e Shtetit ose ajo bashkiake ndalon tregtimin e kafshëve dhe bllokun lëvizjen e kafshëve dhe të produkteve blegtorale.

Neni 15

1. Policia kufitare ndalon tranzitimin e paligjshëm ose transportimin e ngarkesave jashtë pikave të kalimeve kufitare të përcaktuara.

2. Ngarkesa mund të ridrejtohet te një kalim kufitar në rast se për shkak të paditurisë ose ndonjë arsyeje tjetër, shoferi gabimisht ka drejtuar mjetin transportues në kalime kufitare, që nuk janë kalime të inspektimit kufitar.

3. Ngarkesa, sipas pikës 2 të këtij neni, trajtohet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 16

Policia e Shtetit ndihmon shërbimin veterinar në kryerjen e detyrës së tij gjatë aksidenteve në transportin e kafshëve, produkteve me origjinë shtazore, materialeve të papërpunuara dhe mbeturinave.

KREU V KOMPETENCAT E INSPEKTORATIT VETERINAR

Neni 17

1. Inspektimi veterinar kryhet nga inspektorë veterinarë.

2. Inspektorët veterinarë pajisen me “Kartën e identitetit zyrtar”, që lëshohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Inspektori veterinar:

a) kontrollon zbatimin e ligjit veterinar dhe akteve nënligjore në fushën e veterinarisë;

b) kontrollon situatën epizootike të sëmundjeve ngjitëse në kafshë dhe përhapjen e sëmundjeve zoonotike me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik;

c) kontrollon tregtimin e kafshëve, të produkteve dhe nënprodukteve me origjinë shtazore në tregje, magazina, mjedise ftohëse dhe dyqane të shitblerjes së tyre;

ç) kontrollon tregtinë e produkteve mjekësore, të narkotikëve dhe substancave të tjera farmakologjike që përdoren në mjekësinë veterinare dhe i bllokun ato në rast se nuk plotësojnë standardet;

d) kontrollon gjendjen sanitaro-veterinare të produkteve me origjinë shtazore;

dh) kontrollon gjendjen e shëndetit të kafshëve dhe aftësinë e tyre riprodhuese, tregtimin dhe magazinimin e spermës së kafshëve, ovulave, embrioneve, të vezëve për shtrim dhe mbretërshave të bletëve;

e) kontrollon dhe merr masa për mbrojtjen e kafshëve nga tortura;

ë) kontrollon kafshët, produktet me origjinë shtazore dhe materialet e papërpunuara, aditivët, produktet për kafshët, ujin dhe mbeturinat për pastërtinë e tyre higjienike;

f) bllokun prodhimin, tregtimin dhe përdorimin e produkteve për kafshë dhe të ujit në rast se këto përmbajnë agentë patogjenë ose substanca që dëmtojnë shëndetin e kafshëve dhe të njerëzve;

g) bllokon tregtimin e lëkurëve të kafshëve, të cilat janë therur pa kontroll veterinar ose që e kanë origjinën nga kafshë të sëmura, për të cilat nuk është lëshuar certifikatë veterinare për pastërtinë e zonës, ku e kanë origjinën ose kur në magazina këto lëkurë nuk janë veçuar nga lëkurët e kontrolluara;

gj) bllokon përdorimin e mjeteve të transportit, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e përshkruara për transportimin e kafshëve, produkteve me origjinë shtazore, materialeve të papërpunuara, produkteve për kafshët, ujit që pijnë kafshët dhe mbeturinat;

h) bllokon përdorimin e stallave dhe stabilimenteve të rritjes së kafshëve, stacionet dhe pikat për ngarkimin, ringarkimin dhe shkarkimin e kafshëve, në rast se këto nuk plotësojnë kërkesat e përshkruara;

i) bllokon therrjen e kafshëve, mbledhjen dhe përpunimin e materialeve të papërpunuara dhe prodhimin e produkteve me origjinë shtazore në qoftë se kërkesat e përshkruara nuk plotësohen;

j) bllokon lëshimin e certifikatës veterinare në rast vatrash të sëmundjeve ngjitëse ose në raste kur dyshohet për sëmundje ngjitëse;

k) konfiskon dhe shkatërron materiale të papërpunuara, të papërshtatshme nga ana sanitaro-veterinare, produkte me origjinë shtazore, produkte për kafshë dhe prodhimet mjekësore veterinare;

l) urdhëron konsumin me kusht të materialeve të papërpunuara, produkteve me origjinë shtazore, produkteve për kafshët ose përpunimin e produkteve të mësipërme për qëllime të tjera;

ll) urdhëron eliminimin e mangësive në prodhimin dhe tregtimin e kafshëve, produkteve me origjinë shtazore, materialeve të papërpunuara, produkteve për kafshë dhe produkteve mjekësore;

m) pezullon stabilimentet dhe instalimet për mbarështim, prodhim dhe tregtim kafshësh, produkteve me origjinë shtazore për industri, tregti dhe për qëllime të tjera kur këto nuk plotësojnë kriteret sanitaro-veterinare, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;

n) merr kampione dhe i dërgon ato në Institutin e Kërkimeve Veterinare ose në laboratorët rajonalë për analiza bakteriologjike, kimike, mbetje të substancave të dëmshme dhe ndotës të mjedisit;

nj) mbikëqyr tregtinë dhe përdorimin e mjeteve të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit që përcakton ky ligj;

o) kontrollon librat në qendrat prodhuese e përpunuese, regjistrat për rezultatet e ekzaminimeve dhe dokumente të tjera të personave fizikë dhe juridikë në lidhje me zbatimin e rregulloreve në mjekësinë veterinare, si dhe të rregulloreve për tregtimin e barnave veterinare;

p) pezullon lëvizjen e kafshëve, produkteve me origjinë shtazore, materialeve të papërpunuara, produkteve për kafshë, prodhime mjekësore, spermë kafshësh, ovula, embrione, mbeturina shtazore kur këto përbëjnë shkelje të ligjit;

q) urdhëron eliminimin e mangësive në organizimin teknik në dokumentacion;

r) urdhëron bllokimin e veprimtarisë veterinare të palicencuar ose me mangësi në dokumentacion.

Neni 18

Në pikën e inspektimit kufitar, inspektori veterinar ka për detyrë:

a) të bëjë inspektimin sanitaro-veterinar, si dhe kontrollin fizik të ngarkesave për eksport, import dhe tranzit së bashku me dokumentet shoqëruese;

b) të marrë kampione produkteve me origjinë shtazore, materialesh të papërpunuara, mbeturinash dhe produkteve për kafshë për analizë laboratorike kur është e nevojshme;

c) të regjistrojë ngarkesat e eksportit, importit dhe tranzitit, të cilat kalojnë nëpër pikën e kalimit kufitar, sipas përcaktimeve të bëra me rregullore të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit;

ç) të mbikëqyrë dezinfektimin dhe kushtet higjieno-sanitare të mjeteve të transportit dhe të magazinave doganore;

d) të kryejë të gjitha veprimet e tjera që parashikon ky ligj, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 19

1. Në pikën e inspektimit kufitar, inspektori veterinar është pjesë e grupit të praktikës doganore që merr kontaktin e parë me mjetet dhe mallrat që kalojnë në kufi dhe ka të drejtë të bllokojë eksportin, importin dhe tranzitimin e ngarkesave që përmenden në këtë ligj, kur:

a) gjatë inspektimit është zbuluar se ngarkesa është e kontaminuar, dyshohet si e tillë dhe kur ngarkesa ka origjinë nga zona të kontaminuara dhe dëmton ose rrezikon shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve;

b) ngarkesa nuk është e shoqëruar me certifikatën ndërkombëtare sanitaro-veterinare dhe të tjera dokumente shoqëruese, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;

c) produktet me origjinë shtazore të destinuara për konsum publik janë të ndotura me substanca radioaktive, mikrobiologjike ose mbetje kimike më tepër sesa normat e lejuara.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, inspektori veterinar urdhëron:

a) magazinimin e ngarkesës në një magazinë të regjistruar në rastet kur duhet të ekzaminohet gjendja shëndetësore e ngarkesës;

b) masa të tjera për mbajtjen e kafshëve, bazuar në këtë ligj dhe në përputhje me traktatet ndërkombëtare mbi mbrojtjen e shëndetit kafshëve;

c) dezinfektimin e mjeteve të transportit, të pajisjeve dhe instalimeve të përdorura gjatë punimit të ngarkesave;

ç) eliminimin e parregullsive në tregtimin e ngarkesave në pikën e inspektimit veterinar kufitar.

KREU VI VEPRIMTARIA, TË DREJTAT DHE DETYRAT E DHOMËS SË MJEKËVE VETERINERË

Neni 20

1. Dhoma e Mjekëve Veterinerë është ent publik, që përfaqëson interesat e përbashkët të mjekëve veterinerë të Shqipërisë. Veprimtaria, të drejtat dhe detyrat e Dhomës së Mjekëve Veterinerë përcaktohen nga akte nënligjore të miratuara nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Statuti i Dhomës së Mjekëve Veterinerë miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Dhoma e Mjekëve Veterinerë ka këto detyra kryesore:

a) licencon mjekët veterinerë, të cilët kanë mbaruar studimet e larta në mjekësinë veterinare, sipas disa kriterëve të përcaktuara me rregullore të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe statutit;

b) regjistron të gjithë mjekët veterinerë, që kryejnë veprimtari veterinarë;

c) planifikon, monitoron dhe organizon trajnim profesional të mjekëve veterinerë, që punojnë në shërbimin veterinar publik dhe privat;

ç) kryen kontrole në nivel ekspertësh të organizatave veterinare;

d) verifikon dhe regjistron shoqatat veterinare;

dh) bashkëpunon me Drejtorinë e Veterinarisë në përgatitjen e rregulloreve veterinare;

e) bën testimin profesional të mjekëve veterinerë në të gjithë strukturën shtetërore, në bazë të një rregulloreje të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, ku përcaktohet komisioni i testimit dhe materiali i ekzaminimit;

ë) publikon trajnimet ndërkombëtare në fusha të ndryshme të mjekësisë veterinare;

f) mban lidhje të rregullta me organizma ndërkombëtarë, si OIE, BE, FAO, OBT, OBSH, si dhe me organizma homologë;

g) kryen detyra të tjera, të cilat parashikohen nga statuti i saj.

4. Dhoma e Mjekëve Veterinerë detyrohet të lëshojë ose të refuzojë dhënien e licencës veterinare brenda 30 ditëve nga data e aplikimit.

5. Ankesa kundër vendimit dhe masave të Dhomës së Mjekëve Veterinerë bëhet te Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit brenda 15 ditëve nga çasti i refuzimit të licencës.

6. Dhoma e Mjekëve Veterinere është e detyruar që të dhënat e regjistruara t'ia komunikojë menjëherë Drejtorisë Veterinare.

KREU VII

SËMUNDJET NGJITËSE NË KAFSHË, MASAT PËR KONTROLLIN, LAJMËRIMIN, PARANDALIMIN, ELIMINIMIN DHE ÇRRËNJOSJEN E TYRE

Neni 21

1. Sëmundjet ngjitëse në kafshë, që kërkojnë masa të përgjithshme dhe të veçanta veterinare, të parashikuara nga ky ligj, janë të gjitha sëmundjet e përcaktuara nga kodi zoosanitar ndërkombëtar dhe lista e OIE-së.

2. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, me propozim të Drejtorisë Veterinare, shton sëmundjet e reja dhe përcakton masat për luftimin dhe parandalimin e sëmundjeve të listës së OIE-së, në përshtatje me situatat epidemiologjike brenda vendit, në rajon e më gjerë.

3. Në rast rreziku për shpërthimin e sëmundjeve ngjitëse, të cilat nuk figurojnë në listën e OIE-së dhe që mund të rrezikojnë shëndetin e kafshëve ose të njerëzve, zbatohen masat që parashikon ky ligj për mbrojtjen kundër sëmundjeve ngjitëse.

Neni 22

Sëmundjet ngjitëse të kafshëve dhe zoonozat parandalohen dhe kontrollohen duke u bazuar në masat e përgjithshme dhe të veçanta veterinare.

Neni 23

1. Pronari ose kujdestari i kafshëve dhe personat që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me kafshët, produktet me origjinë shtazore, materiale të papërpunuara, mbeturina nga kafshët, karkasa dhe mallrat e konfiskuara, duhet të kenë njohuri bazë për sëmundjet ngjitëse në kafshë, për parandalimin e tyre, transmetimin në njerëz, si dhe të njohin rregulloret për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse në kafshë.

2. Masat e përgjithshme parandaluese, të përcaktuara në ligj për mbrojtjen kundër sëmundjeve ngjitëse të kafshëve që zbatohen nga pronari ose kujdestari i kafshëve dhe personave të tjerë në kontakt me to, janë:

a) sigurimi i kushteve higjienike të përshtatshme të ujit të pijshëm dhe produkteve që përdorin kafshët;

b) sigurimi i kushteve higjienike në stabilimentet e punës racore të kafshëve, në pajisjet e tyre, si dhe në rrethimet e territorit ku ato mbarështohen;

c) sigurimi i kushteve higjienike gjatë procesit të mjeljes së qumështit dhe gjatë aktit të pjelljes;

ç) sigurimi i kushteve higjienike në vendet publike ku mbahen kafshët, në mjete që transportojnë kafshë dhe në stabilimente për rritjen e kafshëve;

d) sigurimi i kushteve të përshtatshme higjienike në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve me origjinë shtazore;

dh) parandalimi i përhapjes së vektorëve të sëmundjeve ngjitëse në kafshë;

e) zbatimi i masave sanitaro-veterinare parandaluese në qendrat racore;

ë) manipulimi i karkasave të kafshëve, i mbeturinave, i ekskrementeve dhe i sekrecioneve, në përputhje me rregulloret përkatëse;

f) dezinfektimi profilaktik, dezinfektimi dhe deratizimi i stabilimenteve, i vendeve publike dhe i mjeteve të transportit.

Neni 24

Drejtoria Veterinare, së bashku me sektorin veterinar të qarkut dhe zyrën veterinare vendore, për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve nga sëmundjet ngjitëse, ka për detyrë:

a) të përcaktojë çdo vit numrin dhe llojin e sëmundjeve ngjitëse, që do t'u nënshtrohen masave diagnostikuese, analizave, ekzaminimeve anatomo-patologjike, vaksinimit, gjurmimit dhe çrrënjësjes së tyre, në përputhje me nenin 21 pika 2 të këtij ligji;

b) të kryejë regjistrimin dhe identifikimin e kafshëve dhe fermave blegtorale, në përputhje me ligjin nr.8702, datë 1.12.2000 "Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale";

c) parandalimin e sëmundjeve ngjitëse në rast katastrofash natyrore dhe në rast sëmundjesh ngjitëse tepër të rrezikshme në vendet kufitare me Shqipërinë, duke realizuar analiza laboratorike për diagnostikimin e tyre, për përcaktimin e shkaqeve të dëmtimeve dhe të masave profilaktike;

ç) monitorimin dhe studimin e situatës epizootike në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe komune dhe përcaktimin e shpenzimeve financiare të nevojshme;

d) certifikimin veterinar, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe rregulloret e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit;

dh) kontrollin e magazinimit dhe ruajtjen në bazë të rregullave të bioprodukteve, dezinfektantëve dhe mjeteve të tjera profilaktike e kurative;

e) trajnimin veterinar të mbarështuesve të kafshëve;

ë) manipulimin pa rrezik të kadavrave të kafshëve.

Neni 25

1. Kompetentë për marrjen e masave të veçanta parandaluese kundër sëmundjeve ngjitëse në kafshë, sipas juridiksionit, janë:

a) sektori veterinar i qarkut, i cili ka për detyrë:

i) identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe fermave;

ii) vendosjen e karantinës;

iii) ekzaminimin diagnostik për përcaktimin e shkaqeve të sëmundjes;

iv) vaksinimin dhe mbrojtjen me anë të produkteve mjekësore;

b) sektori veterinar vendor, i cili ka për detyrë:

i) izolimin dhe largimin e kafshëve të sëmura;

ii) dezinfektimin, dezinfektizimin dhe deratizimin;

iii) depozitimin e padëmshëm në vendet e caktuara të karkasave, konfiskateve dhe mbeturinave të tjera;

iv) depozitimin e padëmshëm ose trajtimin sanitar të jashtëqitjeve;

v) eliminimin e vektorëve të sëmundjeve ngjitëse;

vi) manipulimin pa rrezik të kadavrave të kafshëve.

2. Kryetari i bashkisë ose i komunës, në rast shpërthimi të sëmundjeve epizootike, urdhëron:

a) izolimin e kafshëve të sëmura ose të dyshimta;

b) ndalimin e lëvizjes së kafshëve;

c) mbajtjen të veçuar në vende të posaçme të kafshëve të therura ose të ngordhura deri në ardhjen e inspektorit veterinar;

ç) ndalimin e tregjeve të kafshëve dhe produkteve që rrjedhin prej tyre;

d) caktimin e vendeve për groposjen dhe djegien e kadavrave;

dh) eliminimin e qenve të rrugës.

3. Për zbatimin e masave të pikës 1 të këtij neni hartohen programe afatshkurtra dhe afatgjata për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, duke përcaktuar mënyrat e zbatimit dhe të financimit.

4. Në fund të çdo viti hartohet programi i vaksinimit profilaktik, i diagnozave, si dhe i ekzaminimeve të tjera që do të zbatohen vitin pasardhës për të siguruar situatë të pastër epidemiologjike, duke përcaktuar edhe mënyrat e zbatimit të këtij programi, me qëllim identifikimin, eliminimin dhe çrrënjësjes së sëmundjeve ngjitëse.

Neni 26

1. Masa të veçanta veterinare parandaluese të detyrueshme për mbrojtjen e njerëzve nga zoonozat, të zbatuara nga zyrat veterinare vendore, janë:

a) parandalimi sistematik, identifikimi dhe eliminimi i zoonozave në kafshët shtëpiake dhe në kafshë të tjera;

b) zbatimi i masave parandaluese për mbrojtjen e mjekëve veterinerë, pronarëve ose kujdestarëve të kafshëve, si dhe personave të tjerë që kanë kontakt direkt ose indirekt me kafshët e infektuara, produktet me origjinë prej tyre, materiale të papërpunuara dhe mbeturina;

c) sigurimi i kushteve të përshtatshme sanitaro-veterinare të produkteve me origjinë shtazore, si dhe parandalimi i tregtisë së paligjshme të kafshëve të infektuara, produkteve me origjinë shtazore të papërshtatshme për konsum njerëzor, i materialeve të papërpunuara dhe i mbeturinave;

ç) parandalimi i ndotjeve të materialeve të papërpunuara dhe produkteve me origjinë shtazore në fabrikat e përpunimit të produkteve dhe në stabilimente të tjera.

2. Për zbatimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, hartohen programe afatshkurtra dhe afatgjata për mbrojtjen e publikut nga zoonozat, duke përcaktuar edhe format e zbatimit dhe mënyrat e financimit.

3. Programet për luftimin e zoonozave zbatohen nga shërbimet veterinare dhe të shëndetësisë. Autoritetet veterinare dhe shëndetësore, inspektorati veterinar dhe ai shëndetësor ndërmarrin veprime të përbashkëta në planifikimin e masave mbrojtëse kundër zoonozave.

Neni 27

1. Kur ka vatra të sëmundjeve ngjitëse ose dyshim për kafshë të sëmura apo të ngordhura për shkak të ndonjë sëmundjeje ngjitëse, pronari ose kujdestari i kafshëve detyrohet të izolojë kafshët e sëmura ose të dyshimta nga kafshët e tjera.

2. Pronari ose kujdestari i kafshëve detyrohet të lajmërojë menjëherë në zyrën veterinare më të afërt nëse:

a) shfaqen shenja të dyshimta për ndonjë sëmundje ngjitëse;

b) ka ngordhje të menjëhershme ose sëmundje zoonotike;

c) brenda tetë ditëve në kafshë shfaqen shenja të sëmundjeve të përsëritura në krerë të tjerë.

3. Çdo mjek veteriner, i cili zbulon ose dyshon për vatër të sëmundjeve ngjitëse, përcakton masat veterinare për të parandaluar përhapjen e sëmundjes, si dhe tregtimin e kafshëve të infektuara, materialeve të papërpunuara jo të përshtatshme, si dhe të produkteve me origjinë shtazore. Për të konfirmuar zbulimin ose dyshimin, mjeku veteriner dërgon në laboratorin më të afërt kampione për analizë laboratorike.

Në këto raste mjeku veteriner është i detyruar të informojë sektorin veterinar të qarkut.

4. Detyrimi i lajmërimit shtrihet edhe për veterinerin privat. Ai lajmëron me shkrim shërbimin shtetëror veterinar më të afërt, duke plotësuar të dhënat e formularit të miratuar me akt nënligjor nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

5. Drejtuesit e pushtetit vendor në fshatra e komuna dhe gjuetarët janë të detyruar të lajmërojnë zyrën veterinare më të afërt për çdo shfaqje infeksioni ose dyshim për sëmundje ngjitëse në kafshët e egra.

Neni 28

1. Sektori veterinar i qarkut bën identifikimin e sëmundjeve ngjitëse, përcakton shkakun e ngordhjes së kafshëve, pastërtinë sanitaro-veterinare të materialeve të papërpunuara dhe produkteve me origjinë shtazore, duke përcaktuar në udhëzimet e shkruara masat e nevojshme për të parandaluar përhapjen e sëmundjes dhe tregtimin e kafshëve të sëmura, të produkteve me origjinë shtazore dhe materialeve të papërpunuara që nuk janë higjienikisht të pastra.

2. Sektori veterinar i qarkut siguron veprimtari veterinar dhe laboratorike të përhershme për diagnostikimin e sëmundjeve ngjitëse, bazuar në këtë ligj.

3. Sektori veterinar i qarkut ose zyra veterinarë e bashkisë dhe komunës, në rast dyshimi për sëmundje ngjitëse, dërgojnë në laboratorin veterinar të qarkut ose në Institutin e Kërkimeve Veterinare kampione për analiza laboratorike.

4. Marrja e kampioneve dhe transporti i tyre për në laborator bëhet sipas përcaktimeve në rregulloren e Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit, me qëllim mospërhapjen e infeksionit dhe mënjanimin e kontaminimit dhe dëmtimit të kampioneve gjatë transportit.

Neni 29

1. Në rast shpërthimi vatre të sëmundjes ngjitëse ose dyshim për një vatrë të tillë, sektori veterinar i qarkut urdhëron kontroll epizootik dhe ia paraqet rezultatet e këtij kontrolli Drejtorisë Veterinare, gjithë komunave të rrethit dhe atyre të rretheve fqinje, duke treguar vendin e infeksionit dhe masat veterinarë për luftimin e sëmundjes.

2. Sektori veterinar i qarkut është i detyruar të njoftojë autoritetet shtetërore të qarkut, të cilët shpallin njoftimin zyrtar për gjithë zonën, duke njoftuar veçanërisht pronarët që merren me rritjen e kafshëve.

3. Sektori veterinar i qarkut informon institucionet shëndetësore për vatrën e sëmundjes ngjitëse, të dyshuar si zoonozë, ose për identifikimin e kësaj sëmundjeje me anën e inspektimit veterinar dhe kontrollit të produkteve me origjinë nga kafshët.

KREU VIII

MASAT VETERINARE QË MERREN KUR SHPËRTHEN NJË SËMUNDJE NGJITËSE

Neni 30

1. Kur shpërthen një sëmundje ngjitëse, në varësi të natyrës së saj, si dhe rreziqeve që ajo paraqet në zonën e infektuar ose të rrezikuar për shëndetin e kafshëve dhe të njerëzve, sektori veterinar i qarkut urdhëron inspektorin veterinar për zbatimin e masave të mëposhtme veterinarë:

a) veçimin dhe izolimin e kafshëve të sëmura dhe të dyshimta nga të shëndoshat;

b) ndalimin ose kufizimin e lëvizjeve të ngarkesës;

c) ndalimin e lëshimit të certifikatës veterinarë për lëvizjen e ngarkesës;

ç) ndalimin ose kufizimin e transportit, të tregtimit të produkteve me origjinë shtazore, të materialeve të papërpunuara, mbeturinave, produkteve për kafshë, si dhe të mallrave të tjera, të cilat mund të shërbejnë si vektorë të sëmundjes;

d) ndalimin e therjes ose eliminimit të kafshëve të infektuara e të dyshuara si të tilla, si dhe bllokimin e mallrave të kontaminuara dhe të materialeve të papërpunuara, me përjashtim të rasteve kur lejohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;

dh) ndalimin e riprodhimit të kafshëve deri në zhdukjen e infeksionit në stabilimentin e infektuar;

e) vaksinimin mbrojtës, analizat diagnostikuese dhe mjekimin e kafshëve;

ë) kastrimin e kafshëve që mund të përhapin sëmundje veneriane, si dhe bllokimin e ndërimit natyror;

f) dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e stallave, kullotave, ekskrecioneve, vendeve ku pijnë ujë kafshët, si dhe vendeve të tjera ku kanë qëndruar kafshët e sëmura dhe pajisjeve, të cilat kanë qenë në kontakt me kafshët e sëmura;

g) dezinfektimin e personave që kanë pasur kontakt direkt ose indirekt me vektorët e sëmundjeve ngjitëse;

gj) eliminimin ose izolimin e qenve dhe maceve të rrugës;

h) eliminimin e përbujtësve të ndërmjetëm të infeksionit;

i) zbatimin e masave për çrrënjosjen përfundimtare të vektorëve të sëmundjeve ngjitëse.

2. Masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni urdhërohen për zbatim në rast rreziku direkt për sëmundje ngjitëse.

3. Në rast rreziku tepër të lartë, urdhërohet ndalim i përkohshëm i veprimtarive në stabiliment, si trajtimi, përpunimi ose magazinimi i produkteve me origjinë shtazore, i materialeve të papërpunuara, i mbeturinave ose i produkteve për kafshët.

4. Inspektori veterinar duhet të informojë menjëherë autoritetet e shërbimit shëndetësor për masat e marra në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 31

Një sëmundje ngjitëse konsiderohet e eliminuar atëherë kur pas shërimit, eliminimit ose ngordhjes së kafshës së fundit të sëmurë dhe pas dezinfektimit përfundimtar nuk është shfaqur asnjë shenjë e saj.

KREU IX

MASAT PARANDALUESE SANITARO-VETERINARE NË TRANSPORTIN E KAFSHËVE DHE PRODUKTEVE ME ORIGJINË NGA KAFSHËT

Neni 32

1. Pronari ose kujdestari i kafshëve në tregtinë e brendshme duhet të ketë certifikatë veterinarë, e cila shoqëron lëvizjen e kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore jashtë njësisë epidemiologjike të origjinës.

2. Pronari ose kujdestari i kafshëve duhet të ketë certifikatë veterinarë të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni për:

a) njëthundrakë dhe dythundrakë në rastet e nxjerrjes së kafshëve në panaire, në tregje dhe në të tjera mjedise shitjeje, ekspozita, gara sportive, vende të ndryshme për grumbullimin e kafshëve në publik, kafshëve të vrapimit që dërgohen jashtë zonës administrative, kur nuk kanë vendqëndrim të përhershëm, shitje ose kalim tjetër pronësie, dërgimi i kafshëve në thertore për therje, lëvizjen e kafshëve për në kullota;

b) shpendët, zogjtë dekorativë, lepujt dhe kafshët me gëzof, në rast se dërgohen në thertore për therje, dërgohen jashtë zonës administrative, shitje ose kalim tjetër pronësie, kur dërgohen në ekspozitë;

c) peshq nga qendrat e vaskat e rritjes dhe të punës racore me ta, molusqe, krustace e kafshë uji, në rast se dërgohen jashtë zonës administrative, shitje ose kalim tjetër pronësie;

ç) ngarkesa me parqe bletësh, si dhe mbretëresha, në rast se dërgohen jashtë zonës administrative ose në kullotë, shitje ose kalim tjetër pronësie;

d) qentë dhe macet, në rast se dalin në panaire, ekspozita, gara sportive, dhe çdo vend tjetër grumbullimi kafshësh në vende publike;

dh) të gjitha produktet me origjinë shtazore, bioproduktet dhe medikamentet veterinarë, ushqime për kafshët dhe materiale të tjera biologjike.

3. Certifikata duhet të konfirmojë që asnjë sëmundje ngjitëse nuk përhapet nga kafshët e sipërpërmendura dhe që nuk ka pasur raste sëmundjeje në vendin e origjinës së këtyre kafshëve në çastin e lëshimit të saj.

4. Certifikata veterinarë duhet të jetë e vlefshme për një periudhë të caktuar kohe prej 10 ditësh dhe lëshohet në çastin e ngarkimit të mallit.

5. Certifikata veterinarë nuk lëshohet kur në vendin e origjinës së kafshëve ka pasur sëmundje ngjitëse, e cila mund të përhapet nga llojet e sipërpërmendura të kafshëve.

6. Kafshët për tregtim duhet të jenë të matrikulluara në mënyrë që të identifikohen lehtë.

7. Certifikata veterinarë është tip, e miratuar nga autoriteti kompetent qendror, e unifikuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për lëvizjet e përcaktuara në pikën 2, certifikata lëshohet:

a) nga sektori veterinar i qarkut për lëvizjet brenda dhe jashtë territorit të qarkut;

b) nga zyra veterinarë vendore për lëvizjet brenda dhe jashtë bashkisë dhe komunës.

Neni 33

1. Inspektimi dhe kontrolli sanitaro-veterinar është i detyrueshëm në ngarkimin e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore, materialet e papërpunuara dhe mbeturinat, të cilat me anë të mjeteve të transportit dërgohen jashtë zonës administrative.

2. Pas inspektimit sanitaro-veterinar lëshohet certifikatë veterinare për kushtet sanitaro-veterinare të ngarkesës.

3. Ngarkimi, ringarkimi dhe shkarkimi i ngarkesave, sipas pikës 1 të këtij neni, lejohet në stacione hekurudhore, porte detare, aeroporte dhe vende të tjera vetëm kur ngarkesat plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 34

1. Para ngarkimit dhe pas shkarkimit mjeti i transportit pastrohet dhe dezinfektohet nga transportuesi.

2. Inspektori veterinar, që ka mbikëqyrur dezinfektimin e mjeteve të transportit, lëshon vërtetim për këtë mbikëqyrje, dokument i cili i jepet drejtuesit të mjetit dhe paraqitet në rastet kur ai kërkohet.

Neni 35

Për organizimin e ekspozitave, kopshteve zoologjike, transportin e kafshëve, që udhëtojnë për cirqe, kopshteve zoologjike shëtitëse, shitjeve të organizuara të kafshëve, panairë kafshësh, ose të produkteve të tyre, barnash e biopreparatesh veterinare, materialesh të papërpunuara dhe produkteve me origjinë shtazore jashtë mjedisve të stallave dhe stabilimenteve, organizuesit duhet të marrin miratim paraprak nga inspektori veterinar.

Neni 36

1. Me kërkesën e inspektorit veterinar, policisë dhe autoriteteve të tjera kompetente, pronari, kujdestari ose transportuesit e kafshëve, të produkteve me origjinë shtazore, barnave e bioprodukteve veterinare dhe mbeturinave, duhet të paraqesin certifikatën veterinare.

2. olicia njofton zyrën veterinare më të afërt në rast aksidenti gjatë transportit të kafshëve, produkteve me origjinë shtazore, materialeve të papërpunuara dhe mbeturinave.

3. Zyra veterinare, që lajmërohet për aksidentin, duhet të sigurojë ndihmë për kafshët dhe produktet me origjinë shtazore të aksidentuara.

4. Thertorja më e afërt duhet të sigurojë transportin dhe manipulimin e kafshëve të dëmtuara, të materialeve të papërpunuara dhe të produkteve me origjinë shtazore nga vendi ku ka ndodhur aksidenti.

5. Për kafshët me hemoragji të rëndë dhe fraktura të pariparueshme inspektori veterinar urdhëron eliminimin në vend të kafshëve.

KREU X

MASAT PARANDALUESE PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË KAFSHËVE, PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE DHE PRODUKTEVE TË TJERA BIOLOGJIKE

Neni 37

1. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit përcakton me rregullore mënyrën e ngarkimit, ringarkimit dhe shkarkimit të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë prej tyre që importohen, tranzitohen ose eksportohen.

2. Ngarkimi, ringarkimi, shkarkimi, magazinimi, përpunimi i ngarkesave, sipas nenit 32 pika 2 të këtij ligji, duhet të jetë subjekt i inspektimit të detyrueshëm sanitaro-veterinar.

3. Për speciet e faunës së egër, të gjitha veprimet e sipërpërmendura kryhen konform rregullave të përcaktuara në Konventën “Për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”, të miratuar me ligjin nr.9021, datë 6.3.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”.

Neni 38

1. Ngarkesat e kafshëve, të produkteve me origjinë shtazore, materialet e papërpunuara dhe mbeturinat për eksport mund të shkarkohen, ringarkohen dhe magazinohen në pikën e kalimit kufitar vetëm pas inspektimit dhe kontrollit sanitaro-veterinar.

2. Certifikata veterinare për ngarkesat që eksportohen lëshohet nga inspektori veterinar i pikës së kalimit kufitar, bazuar në certifikatën e lëshuar në çastin e ngarkimit, sipas nenit 32 të këtij ligji.

3. Stabilimentet e kafshëve, qendrat e karantinës, magazinat për produkte me origjinë shtazore, si dhe materialet e papërpunuara në pikat e kalimit kufitar duhet të plotësojnë kërkesat sanitaro-veterinare të përshkruara me rregullore të veçantë.

4. Ndalohet eksporti jashtë kufijve shtetërorë i kafshëve të sëmura, si dhe i kafshëve ekzotike, shtëpiake ose të egra, që me ligj janë përcaktuar si pasuri kombëtare e ndaluar për eksport.

5. Pikat e kalimit kufitar, ku lejohet hyrja dhe dalja e kafshëve të gjalla, përcaktohen me urdhër të veçantë të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 39

1. Autoritetet doganore ndalohen të fillojnë procedurat e përpunimit të ngarkesës, kur inspektori veterinar i pikës së kalimit kufitar nuk ka dhënë miratimin zyrtar për lejimin e fillimit të procedurës së përpunimit doganor.

2. Autoritetet doganore detyrohen t'i japin përparësi kalimit në dogana të kafshëve të gjalla dhe materialeve e produkteve ushqimore me origjinë nga kafshët, që rrezikohen të dëmtohen.

Neni 40

1. Lejohet të bëhet importi, eksporti dhe tranzitimi i kafshëve të gjalla, i produkteve dhe i nënprodukteve me origjinë prej tyre, i materialeve të papërpunuara, i materialeve biologjike, biopreparateve, medikamenteve veterinare dhe ushqimeve për kafshë në territorin e Republikës së Shqipërisë, vetëm pasi t'i jenë nënshtruar inspektimit veterinar në pikën e kalimit kufitar dhe janë gjetur të pastra nga sëmundje ngjitëse e çdo ndotje e dëmshme, si dhe të shoqëruara me certifikatën sanitaro-veterinare ndërkombëtare. Ngarkesa shoqërohet me të gjithë dokumentacionin që vërteton identitetin dhe origjinën e mallit.

2. Importi dhe tregtimi i biopreparateve dhe i medikamenteve veterinare në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm pasi ato të jenë regjistruar në librin shtetëror të regjistrimit të medikamenteve. Para regjistrimit këto ngarkesa i nënshtrohen kontrollit në laboratorin shtetëror të kontrollit veterinar.

3. Drejtoria Veterinare, pas regjistrimit të biopreparateve dhe medikamenteve veterinare, autorizon inspektorët veterinarë të pikave kufitare të lejojnë importin e tyre.

4. Biopreparatet ose medikamentet veterinare, të cilat me vendim të organizmave ndërkombëtarë si BE, OMS dhe OIE hiqen nga përdorimi për shkak se janë cilësuar si të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, ndalohen të hyjnë dhe të përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Nuk lejohet importimi dhe tranzitimi i ngarkesës në rast se ajo vjen nga një zonë e infektuar me sëmundje ngjitëse e një vendi eksportues ose në rast se ngarkesa kalon tranzit në një zonë të infektuar me sëmundje ngjitëse të një vendi tjetër gjatë transportit.

6. Për importimin e kafshëve të egra joautoktone, importuesi, në përputhje me rregulloret, merr një miratim paraprak nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe genofondit autokton.

7. Ndalohet importimi dhe futja e mikroorganizmave të gjallë, si bakterie, viruse dhe myqe, të cilat janë patogjene për kafshët, por në raste të veçanta Drejtoria e Veterinarisë lejon importimin e mikroorganizmave nga qendra dhe organizata kërkimore-shkencore për qëllime kërkimore dhe prodhim bioproduktesh.

8. Importimi i ngarkesave, sipas nenit 32 pika 2 të këtij ligji, në Republikën e Shqipërisë lejohet nga vende, të cilat përmbushin kërkesat e Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive, të organizatave ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është anëtare dhe plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë ligj e në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 41

1. Në rast se gjatë importit, eksportit ose tranzitit të ngarkesave të përcaktuara në nenet 37, 38, 39 dhe 40 të këtij ligji, inspektori veterinar i pikës së kalimit kufitar dyshon për sëmundje ngjitëse, ndotje, ndryshime organoleptike të mallit ose konstaton mangësi në dokumentacionin e parashikuar nga neni 40 pikat 1, 2 e 3, urdhëron bllokimin e tij. Për këtë ai mban procesverbal dhe njofton menjëherë sektorin veterinar të qarkut.

2. Përgjegjësi i sektorit veterinar të qarkut kryen verifikim në vend dhe jep vendimin përfundimtar duke urdhëruar pronarin ose kujdestarin e ngarkesës për:

- a) ndalimin e futjes së ngarkesës në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) rikontrollin veterinar me analiza laboratorike të specifikuar;
- c) konfiskimin dhe groposjen e mallit;
- ç) marrjen e masave të tjera parandaluese e mjekuese.

Neni 42

1. Kafshët e importuara, përpara se të dërgohen në destinacion, mbahen në karantinë jo më pak se 21 ditë për të kryer të gjitha ekzaminimet e nevojshme veterinare. Të gjitha shpenzimet për ditët e karantinës përballohen nga importuesi.

2. Karantina shtetërore veterinare ngrihet në një vend të përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit me fondet e shtetit ose nëpërmjet kontraktimit me subjekte private. Ajo organizohet dhe funksionon në bazë të një rregulloreje të veçantë të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit

3. Karantina, lloji i ekzaminimeve, mjeku veterinar që kryen ekzaminime, si dhe kushtet e tjera të karantinës përcaktohen dhe mbikëqyren nga sektori veterinar në qark.

4. Nuk futen në karantinë njëthundrakë, dythundrakë, shpendë dhe lepuj të importuar për therje të menjëhershme brenda 72 orëve nga vende me situatë të pastër epizootike, të cilët nuk paraqesin rrezik për popullacionin e kafshëve të Republikës së Shqipërisë. Therja bëhet vetëm në thertore të miratuara nga autoriteti kompetent veterinar vendor.

Neni 43

1. Importimi, eksportimi, tranzitimi i ngarkesave të kafshëve, produkteve me origjinë shtazore, materialeve të papërpunuara, mbeturinave, produkteve për kafshë dhe produkteve mjekësore për përdorim në mjekësinë veterinare, spermës së kafshëve, ovulave dhe embrioneve, mallrave të tjera, të cilat mund të jenë vektorë të sëmundjeve ngjitëse, lejohen vetëm në pika të kalimit kufitar të përcaktuara nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Pikat e inspektimit kufitar veterinar vendosen në mjedise që plotësojnë kushtet higjienike, teknike dhe operative. Fondet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

3. Eksporti, tranziti, importi nëpër pikat e inspektimit kufitar veterinar i materialeve të përcaktuara në këtë ligj bëhet me tarifë veterinarë të përcaktuar me rregullore të përbashkët të Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë të Financave. Të ardhurat derdhen në buxhetin e drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit të qarkut ku ndodhet pika e inspektimit kufitar veterinar.

Neni 44

Në import, eksport dhe tranzit, ngarkesat që përmenden në nenin 32 pika 2 të këtij ligji duhet të shoqërohen nga certifikata veterinarë ndërkombëtare, sipas Kodit Ndërkombëtar të Shëndetit të Kafshëve, ndërsa eksporti në vendet e BE-së shoqërohet me certifikatë tip të miratuar nga BE-ja.

KREU XI

MASAT SANITARO-VETERINARE NË PRODHIMIN, PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE PËR KONSUM PUBLIK DHE KONSUM NGA KAFSHËT

Neni 45

1. Autoriteti veterinar kompetent në qark, bashki e komunë kontrollon kushtet sanitaro-veterinare në thertore, në stabilimentet e prodhimit të mishit, në frigoriferët, në qendrat e përpunimit të produkteve dhe nënprodukteve blegtorale dhe të tregtimit të tyre, në stabilimentet e prodhimeve të detit dhe akuakulturës, si dhe jep leje për ngritjen dhe funksionimin e tyre. Ata kanë kompetencë të pezullojnë deri në mbyllje këtë veprimtari kur konstatohen shkelje të këtij ligji.

2. Inspektimi dhe kontrolli sanitaro-veterinar është i detyrueshëm për njëthundrakët, dythundrakët, shpendët dhe lepujt përpara therjes, si dhe për mishin e njëthundrakëve, dythundrakëve, shpendëve, lepujve dhe kafshëve të gjahut, peshkut, qumështit e nënprodukteve të tij dhe vezëve, produkteve të mishit, mjaltit, midhjeve, krustaceve, bretkocave për konsum publik para nxjerrjes së tyre në treg.

3. Inspektimi dhe kontrolli sanitaro-veterinar është, gjithashtu, i detyrueshëm për stabilimentet dhe pajisjet për therje të kafshëve të përcaktuara në pikën 2, për stabilimentet dhe pajisjet për trajtimin dhe përpunimin e mishit, peshkut midhjeve, bretkocave, qumështit, mjaltit, vezëve, për stabilimentet dhe pajisjet e magazinimit të tyre, për materialet e papërpunuara, për aditivët që përdoren për trajtim, ruajtje dhe përpunim të produkteve me origjinë shtazore në këto stabilimente dhe për mjetet e transportit.

4. Inspektimi sanitaro-veterinar i kafshëve për therje, si dhe inspektimi i produkteve me origjinë shtazore, që përmenden në këtë nen, për konsum publik, duhet të bëhet në thertore dhe në stabilimentet e prodhim-përpunimit. Kontrolli dhe mbikëqyrja e produkteve me origjinë shtazore duhet të bëhet në magazina, tregje, si dhe në stabilimente të tjera shitjeje.

5. Të paktën brenda 24 orëve përpara fillimit të prodhimit pronari ose kujdestari i kafshëve duhet të raportojë tek autoriteti kompetent veterinar therjen e kafshëve ose prodhimin e produktit, që është subjekt i kontrollit dhe inspektimit të detyrueshëm veterinar.

6. Në therje të sforcuar të njëthundrakëve dhe dythundrakëve është i detyrueshëm inspektimi i mishit të tyre që mund të përdoret për konsum shtëpiak ose për të ushqyerit e kafshëve.

7. Inspektimi veterinar i njëthundrakëve dhe dythundrakëve të sëmurë përpara therjes dhe pas therjes është i detyrueshëm kur mishi i tyre mund të përdoret për konsum publik ose për kafshët.

Neni 46

1. Kur inspektori veterinar, bazuar në inspektimin sanitaro-veterinar dhe të tjera kërkime, vendos që një produkt me origjinë shtazore është i pastër për konsum publik, atëherë ky produkt certifikohet, vulozet dhe lejohet tregtimi, trajtimi ose përpunimi i tij, sipas rekomandimeve përkatëse teknike.

2. Kur inspektori veterinar, bazuar në inspektim dhe të tjera kërkime, vendos që një material i papërpunuar ose produkt me origjinë shtazore nuk përmbush kërkesat sanitaro-veterinare për konsum publik, ky material i papërpunuar ose produkt me origjinë shtazore ndalohet të tregtohet dhe të konfiskohet, sipas rregullave përkatëse.

3. Produktet me origjinë shtazore të nxjerra në treg për konsum publik pa inspektim dhe kontroll sanitaro-veterinar ose pa certifikatë veterinarë apo vulë veterinarë, janë të papërshtatshme dhe ndalohet përdorimi i tyre për konsum publik.

4. Të gjitha kafshët e gjahut, të destinuara për konsum publik, inspektohen nga inspektorë veterinarë dhe shoqërohen nga certifikatë veterinarë.

5. Pronari ose kujdestari i kafshëve për therje dhe përpunuesi ose trajtuesi, transportuesi dhe tregtuesi i produkteve me origjinë shtazore dhe i materialeve të papërpunuara, ka të drejtë të kërkojë përsëritjen e analizave kur rezultati i analizës së parë ka dalë pozitiv. Analiza përsëritet vetëm në kampionin e ruajtur në laboratorët ku analiza është kryer dhe jo në një kampion të marrë rishtas.

Neni 47

Kafshët e sëmura, të cilat dërgohen në thertoren më të afërt për therje, shoqërohen nga një certifikatë veterinarë. Inspektimi përfundimtar sanitaro-veterinar i këtyre kafshëve, si dhe vlerësimi i mishit të kafshëve të therura me urgjencë bëhet në thertore.

Neni 48

1. Pronari ose kujdestari i kafshëve për prodhim qumështi dhe të produkteve të tij që dalin në treg për konsum publik, detyrohet të regjistrojë këtë veprimtari te sektori veterinar i qarkut.

2. Sektori veterinar i qarkut i lëshon pronarit ose kujdestarit të kafshëve për prodhim qumështi leje për tregtimin e qumështit dhe produkteve të tij për konsum publik vetëm atëherë kur plotësohen parametrat sanitaro-veterinarë dhe është i regjistruar në zyrën veterinarë përkatëse.

3. Kur sektori veterinar i qarkut nxjerr konkluzion se nuk janë plotësuar parametrat sanitaro-veterinarë të përcaktuar, ai shfuqizon lejen me urdhër të veçantë dhe bllokon tregtimin e qumështit.

4. Kur në analizën laboratorike qumështi dhe nënproduktet e tij rezultojnë me ngarkesa mikrobike, toksikologjike dhe radiobiologjike mbi normën e lejuar, ndalohet tregtimi dhe përdorimi i tyre për konsum publik.

Neni 49

Sektori veterinar i qarkut inspekton dhe kontrollon kafshët e gjalla, materialet e papërpunuara, produktet me origjinë shtazore dhe ushqimet për kafshë, për praninë e të gjitha llojeve të mbetjeve me ndikime të dëmshme në shëndetin e kafshëve dhe njerëzve, sipas Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve dhe rregullores së Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit. Analizat për mbetjet realizohen në Institutin e Kërkimeve Veterinarë dhe në laboratorët rajonalë.

Neni 50

1. Personat fizikë dhe juridikë të regjistruar në prodhimin dhe tregtimin e ushqimeve për kafshë duhet të sigurojnë kushtet sanitaro-veterinare gjatë të gjitha fazave të prodhimit, transportimit dhe tregtimit të tyre.

2. Tregtimi i ushqimeve për kafshë, që nuk përmbushin kushtet sanitaro-veterinarë është i ndaluar.

3. Ushqimet për kafshë janë të papërshtatshme atëherë kur:

a) përmbajnë mikroorganizma patogjenë, myqe ose parazitë që dëmtojnë shëndetin e kafshëve;

b) përmbajnë substanca anabolizante, hormonale, tirostatike të përdorura për qëllime stimulimi;

c) përmbajnë mbetje të pesticideve, klororganikëve, substanca radioaktive dhe të tjera substanca të dëmshme që tejkalojnë nivelin e lejuar;

ç) janë të ndryshuara nga pikëpamja organoleptike, kanë sasi të dekompozuar, ndikojnë negativisht në riprodhimin dhe shëndetin e kafshëve dhe u ka kaluar afati i përdorimit.

4. Përpara se ushqimet për kafshë të dalin në treg, personat juridikë dhe fizikë të regjistruar për prodhimin dhe përpunimin e tyre me qëllim tregtimi, duhet të bëjnë analiza në laboratorë të miratuar, në përputhje me aktet nënligjore për këtë qëllim.

5. Ushqimet, që përdoren për kafshë, si ato të thjeshta me origjinë bimore dhe shtazore ose të përbëra me plotësuesit me ndikim mjekues ose stimulues të vendit apo të importuara, lejohen të dalin në treg pasi të jenë shoqëruara me certifikatën veterinare të lëshuar nga sektori veterinar i qarkut, ku përfshihen të dhënat e analizave, si dhe standardet e miratuara për këto produkte.

6. Inspektorati Veterinar bën inspektimin dhe kontrollin sanitaro-veterinar të produkteve për përdorim në kafshë, si dhe të stabilimenteve për prodhimin e tyre dhe magazinimin me qëllime tregtimi. Ai ndalon dhe pezullon përdorimin dhe veprimtarinë e tyre, kur ato rezultojnë të infektuara dhe nuk plotësojnë kushtet sanitaro-veterinare.

Neni 51

1. Therja e kafshëve, prodhimi i produkteve me origjinë shtazore dhe materialeve të papërpunuara për konsum publik lejohen vetëm në thertore e në stabilimente të miratuara, që ngrihen e funksionojnë në përputhje me rregulloren e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe kanë siguruar lejen veterinare nga autoriteti kompetent vendor.

2. Administrata Veterinare, pas dhënies së lejes, kodifikon stabilimentin e kontrolluar dhe e regjistron atë. Vetëm në raste të veçanta, njëhundrakët dhe dythundrakët për konsum publik mund të theren jashtë thertores, në pika therjeje të miratuara dhe vetëm nën kontrollin veterinar.

Neni 52

Ndalohet eksportimi i kafshëve të gjalla, i produkteve dhe nënprodukteve të tyre, të cilat nuk janë prodhuar në stabilimente të miratuara e të certifikuara për eksport nga autoriteti kompetent veterinar, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 53

Stabilimentet e rritjes së kafshëve, thertoret, inkubatorët, stabilimentet e prodhimit, përpunimit, të mbledhjes dhe prodhimit të materialeve të papërpunuara, si dhe të gjitha produkteve me origjinë shtazore që eksportojnë, inspektohen nga Drejtoria Veterinare dhe struktura të tjera të shërbimit dhe Inspektoratit Veterinar të autorizuar prej saj.

Neni 54

1. Personi fizik ose juridik, që grumbullon ose tregton lëkurë kafshësh dhe i përpunon ose jo ato, kur vijnë nga njëthundrakë dhe dythundrakë të therur pa kontroll sanitaro-veterinar, si dhe lëkurët e papërpunuara të këtyre kafshëve, detyrohet t'i magazinonjë ato në mjedise të veçanta dhe të izoluara nga të tjerat.

2. Lëkurët e gjedhëve, të dhenve dhe dhive, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nuk lejohet të tregtohen dhe të përpunohen pa kryer analizën për sëmundjen e plasjes në Institutin e Kërkimeve Veterinare.

3. Personi fizik ose juridik, sipas pikës 1 të këtij neni, dokumenton origjinën e lëkurëve të blera, siguron certifikatë veterinare të origjinës dhe është i detyruar të ketë rezultatin e analizës për sëmundjen e plasjes.

4. Qendrat dhe fabrikat e grumbullimit dhe të përpunimit të lëkurëve detyrohen të marrin masa për mosndotjen e mjedisit përmes shkarkimeve, mbetjeve dhe gazrave që dalin nga procesi teknologjik.

KREU XII MASAT VETERINARE NË RIPRODHIMIN E KAFSHËVE

Neni 55

1. Qendrat e punës racore, stacionet e inseminimit, tufat e kafshëve, tufat riprodhuese të shpendëve, inkubatorët, qendrat e punës racore me fazanët, fermat e peshkut, të rritjes së mbretërëshave të bletëve duhet të jenë të pastra nga sëmundjet ngjitëse.

2. Mbledhja dhe magazinimi i spermës së kafshëve, ovulave dhe embrioneve, si dhe metodat e përdorura për mbledhje dhe magazinim i nënshtrohen rregullisht kontrollit sanitaro-veterinar.

3. Zyrat veterinare të qarkut kontrollojnë sistematikisht qendrat e inseminimit, qendrat e punës racore, kushtet sanitaro-veterinare lidhur me aftësitë riprodhuese të kafshëve, kontrollojnë kushtet sanitaro-veterinare për mbledhjen, prodhimin, magazinimin, tregtimin e spermës së kafshëve, ovulave dhe embrioneve, bazuar në rregulloret përkatëse dhe në bazë të këtij kontrolli lejojnë ose bllokojnë veprimtarinë e këtyre qendrave.

Neni 56

1. Ndalohet mbledhja e spermës së kafshëve në rast se dyshohen se janë të infektuara nga sëmundje ngjitëse ose janë të sëmura nga një sëmundje, e cila transmetohet në kafshë të tjera me material biologjik, ovula ose embrione të të njëjtit lloj kafshe.

2. Ndalohet tregtimi dhe përdorimi i spermës së kafshëve, ovulave dhe embrioneve, të cilat janë të kontaminuara ose që kanë veti morfologjike, biokimike dhe biofizike të ndryshuara.

Neni 57

Autoriteti kompetent veterinar kontrollon gjendjen shëndetësore riprodhuese të kafshëve në ndërzimin natyror dhe inseminimin artificial, kontrollon regjistrat e inseminimit dhe i raporton sektorit veterinar në qark për çdo rast dyshimi për sëmundje veneriane ose sëmundje tjetër ngjitëse.

KREU XIII MBROJTJA E MJEDISIT

Neni 58

1. Pronari ose kujdestari i kafshëve që merret me rritjen e kafshëve, me përdorimin dhe tregtimin e tyre, të materialeve të papërpunuara, të produkteve me origjinë shtazore, të ushqimeve për kafshët, të mbeturinave shtazore, si dhe me transportin e kafshëve, është i detyruar të parandalojë ndotjen e mjedisit dhe pasojat në shëndetin e kafshëve dhe të njerëzve.

2. Mbeturinat duhet të manipulohen në përputhje me rregulloren e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Masat parandaluese të mbrojtjes së mjedisit përfshijnë:

a) sigurimin e largimit, përpunimit, trajtimit dhe përdorimit të përshtatshëm të mbeturinave të lëngshme dhe solide;

b) sigurimin e depozitimit të përshtatshëm të mbeturinave të lëngshme dhe solide;

c) trajtimin higjienik të jashtëqitjeve dhe mbeturinave të lëngshme;

ç) pakësimin e rreziqeve të infeksionit, duke përcaktuar kushtet sanitaro-veterinare të përshtatshme në stalla dhe mjedise, si mikroklimë, ulje të nivelit të amoniakut, depozitim mbeturinash dhe jashtëqitjesh, pastrim dhe dezinfektim;

d) parandalimin e ndotjes së ujërave nga mikrobet e sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare.

Neni 59

1. Pronari ose kujdestari i kafshëve informon për ngordhjen e kafshëve zyrën veterinare më të afërt.

2. Zyra veterinare siguron transportimin e kadavrave të kafshëve nga vendi i ngordhjes për në qendrat e përcaktuara për përpunim post mortem, sipas rregullave sanitaro-veterinare. Këto qendra vendosen nga pushteti vendor me pëlqimin e zyrës veterinare, në bazë të rregullores së Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit. Shpenzimet për qendrat e përpunimit të kadavrave mbulohen nga buxheti i pushtetit vendor në komunë ose bashki.

3. Në rast se dyshohet që kadavra i përket një kafshe të ngordhur nga një sëmundje ngjitëse, atëherë duhet të përcaktohet shkaku i vërtetë i ngordhjes.

4. Pronari ose kujdestari i kafshëve me veprimtari blegtorale që nxjerr mbeturina është i detyruar t'i transportojë ato, sipas rregullave, në depon më të afërt të grumbullimit ose në fabrikën e përpunimit të mbeturinave.

5. Fabrikat e përpunimit të kadavrave dhe pajisjet e tjera të trajtimit post mortem duhet të sigurojnë rregulla dhe të kenë shërbim të përhershëm për të përcaktuar shkakun e ngordhjes. Ky shërbim duhet, gjithashtu, të marrë masa të tjera të veçanta parandaluese kundër përhapjes së sëmundjeve infektive në këto qendra.

6. Zyra veterinare vendore, me ndihmën e organeve të pushtetit vendor, detyrohet të sigurojë transportimin e kadavrave dhe mbeturinave të tjera, asistencën post mortem, dezinfektimin e vendit të ngordhjes, të pajisjeve post mortem dhe të mjeteve të transportit.

Neni 60

Në raste të veçanta, me lejen e inspektorit veterinar, kadavrat e kafshëve grupohen ose digjen në një vend të caktuar nga organet e pushtetit vendor, i cili plotëson kërkesat veterinare.

KREU XIV SHPENZIMET PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT TË KAFSHËVE

Neni 61

1. Shërbimi veterinar shtetëror financohet nga:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) mjetet financiare të siguruara nga veprimtaria veterinare;
- c) burime të tjera të brendshme dhe të jashtme të dokumentuara;
- ç) sponsorizime nga persona fizikë e juridikë vendas e të huaj për veprimtari shkencore kualifikuese ose sigurim aparaturash dhe mjeteve pune.

2. Tarifat e shërbimeve veterinare, që kërkohen për qëllimin bazë të mbrojtjes së shëndetit të kafshëve, përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit. Sektori veterinar i qarkut merr një pjesë të të ardhurave të saj nga shërbimet veterinare, duke i përdorur sipas këtij ligji.

3. Burimet financiare të shërbimit veterinar kombëtar, të ligjëruara nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e tjera përdoren:

- a) për zbatimin e programeve monitoruese të situatave epidemiologjike, zbatimin e Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve, si dhe të sigurisë ushqimore;
- b) për mirëmbajtjen dhe forcimin e infrastrukturës veterinare;
- c) për pjesëmarrje në veprimtari veterinare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 62

Shpenzimet që kryhen për kontrollin e sëmundjeve së listës së OIE-së, të cilat shkaktojnë dëmtime në masë të kafshëve, si dhe paraqesin rrezik për shëndetin publik, mbulohen nga shteti. Përdorimi i fondit për këtë qëllim bëhet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 63

Shpenzimet që kryhen për sëmundje të grupit të zoonozave, shpenzimet për Planin Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve dhe ato të ngritjes e funksionimit të stacionit të karantinës shtetërore veterinare përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Përdorimi i tij bëhet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 64

Vaksinimet dhe gjurmimet e detyruara në programet e veçanta të parashikuara nga ky ligj bëhen falas. Shpenzimet e prodhimit të vaksinave dhe diagnostikimeve për këto sëmundje administrohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, sipas skemave të zbatimit që përcaktohen në programe të veçanta.

Neni 65

1. Për njëthundrakët dhe dythundrakët, që në këtë ligj parashikohet të theren, të eliminohen dhe të groposen, ose për të cilat vërtetohet se kanë ngordhur pas vaksinimit të urdhëruar, në mbështetje të vendimeve të marra nga autoritetet kompetente veterinare, pronarit të tyre i jepet kompensim nga fondi shtetëror, në masën e vlerës së dëmit të parashikuar nga ky ligj.

2. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit me rregullore të veçantë përcakton rastet e eliminimit ose therje të detyruara të kafshëve dhe shpendëve të prekura nga sëmundjet ngjitëse, të rrezikshme për shëndetin e tyre dhe të njerëzve.

Neni 66

Komisioni për caktimin e vlerës së kafshëve të sëmura që do të eliminohen dhe do të dëmshpërblehen përbëhet nga inspektori veterinar në komunën ose bashkinë ku ndodhet kafsha, një përfaqësues i pushtetit vendor dhe një përfaqësues i sektorit veterinar të qarkut, i cili kryeson komisionin.

Neni 67

1. Shteti është i detyruar të kompensojë pronarët ose kujdestarët e kafshëve në rastet kur:

a) vatrast ose sëmundjet ngjitëse të dyshuara janë lajmëruar menjëherë sapo kanë shpërthyer shenjat e para;

b) vaksinimet profilaktike dhe ekzaminimet diagnostike të kafshëve janë bërë brenda periudhës së përcaktuar me akte nënligjore;

c) janë zbatuar dhe janë urdhëruar të tjera masa për parandalimin dhe eliminimin e sëmundjeve;

ç) është bërë regjistrimi i fermës dhe identifikimi i kafshës.

2. Kompensimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk paguhet në rast se sëmundja shpërthen gjatë importimit të kafshëve ose gjatë periudhës së qëndrimit në karantinë të kafshëve të importuara dhe në rastet kur pronari është vetë fajtor për shpërthimin e sëmundjes, duke blerë kafshë të sëmura ose të dyshimta pa certifikatë veterinare.

Neni 68

1. Kompensimi, sipas nenit 67 pika 1 të këtij ligji, bëhet në përputhje me vlerën e kafshës, të materialeve të papërpunuara dhe objekteve. Vlera e kafshëve të llojeve të ndryshme përcaktohet nga komisioni i vlerësimit të kafshëve të sëmura, që do të eliminohen dhe do të dëmshpërblehen. Në rastet e kafshës së therur në mënyrë emergjente, të objektit ose materialit të papërpunuar, të dëmtuar pjesërisht, kompesimit i zbritet vlera e pjesës që mund të përdoret.

2. Procedura e pagesës së kompensimit duhet bërë me kërkesën e pronarit ose kujdestarit të kafshëve. I interesuari duhet të paraqesë të gjitha dokumentet e kërkuara nga sektori veterinar i qarkut për kompensim brenda 30 ditëve. Nuk paguhet taksë për procedurën e kërkesës për kompensim.

3. Autoriteti veterinar i qarkut vendos për pagesën dhe masën e kompensimit.

4. Pala e interesuar ka të drejtë të apelojë vendimin e autoritetit veterinar të qarkut brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit pranë Drejtorisë Veterinare.

Neni 69

Pronari ose kujdestari i kafshëve, manipuluesi i materialeve të papërpunuara, produkteve me origjinë shtazore dhe mbeturinave, importuesi e eksportuesi mbulojnë shpenzimet e shërbimeve për zbatimin e masave të parashikuara nga ky ligj, si dezinfektimet, shpenzime për masat veterinare gjatë transportit, importimit, eksportimit, tranzitimit, shpenzimet për karantinën dhe shpenzimet për masat karantinore.

KREU XV

INSTITUTI I KËRKIMEVE VETERINARE DHE LABORATORI SHTETËROR I KONTROLLIT TË BIOPRODUKTEVE VETERINARE

Neni 70

Instituti i Kërkimeve Veterinare është e vetmja qendër reference laboratorike kombëtare dhe pjesë e rrjetit të shërbimit veterinar kombëtar. Instituti i Kërkimeve Veterinare ushtron veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 71

Instituti i Kërkimeve Veterinare është institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Instituti i Kërkimeve Veterinare kryen punë kërkimore shkencore me shpenzime që përballohen nga shteti, sipas akteve nënligjore përkatëse. Ai ka, gjithashtu, pavarësi në veprimtarinë e vet financiare për shërbimet që kryen.

Neni 72

Detyrat e Institutit të Kërkimeve Veterinare janë:

a) monitorimi i situatës epizootike të vendit për sëmundjet virale, bakteriale, mykotike, parazitare, zoonotike dhe helmimeve;

b) diagnostikimi i sëmundjeve dhe përcaktimi i skemave më efikase për luftimin e tyre;

c) prodhimi i biopreparateve veterinare, si vaksina, antigene, alergene, materialeve diagnostikuese, si antigene, serume hiperimune për përdorim në diagnostikimin e sëmundjeve dhe në luftimin e tyre;

ç) kontrolli mikrobiologjik, kimik, toksikologjik dhe radiobiologjik i produkteve dhe i nënprodukteve ushqimore me origjinë shtazore dhe i ushqimeve të kafshëve, të prodhuara në vend ose të importuara, si dhe ato për eksport;

d) kontrolli i mbetjeve të substancave me efekt anabolik dhe të paautorizuara, i biopreparateve dhe i medikamenteve veterinarë në kafshët dhe shpendët e gjalla, si dhe produktet e tyre;

dh) kualifikimi i specialistëve të laboratorëve veterinarë rajonalë, certifikimi i farmacistëve veterinarë dhe trajnimi periodik i tyre.

Neni 73

Instituti i Kërkimeve Veterinare, bazuar në norma dhe standarde të njohura ndërkombëtare, harton, miraton dhe shpërndan teknikat dhe metodat analitike përkatëse në fushën e veprimtarisë së vet ligjore. Bashkëpunon me institute e qendra kërkimore shkencore homologe dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë, si dhe me institute e qendra reference brenda vendit.

Neni 74

Në varësi administrative dhe teknike të Institutit të Kërkimeve Veterinare janë laboratorët veterinarë rajonalë. Laboratorët veterinarë rajonalë vendosen pranë drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit në qark dhe ushtrojnë detyrën e tyre në diagnostikimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve e shpendëve, si dhe në kontrollin e ushqimeve me origjinë shtazore dhe ushqimeve të kafshëve. Këta laboratorë zbatojnë detyrat që i delegohen nga Instituti i Kërkimeve Veterinare për ndjekjen e situatës epizootike të qarkut, mbështesin shërbimin veterinar rajonal në hartimin dhe zbatimin e programeve për monitorimin dhe eliminimin e sëmundjeve, për minimizimin dhe eliminimin e rreziqeve për njerëzit.

Neni 75

Instituti i Kërkimeve veterinarë certifikon të gjithë laboratorët veterinarë privatë dhe ata të subjekteve private.

Neni 76

1. Në varësi të Drejtorisë Veterinare ngrihet dhe funksionon Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar, që kontrollon biopreparatet dhe medikamentet veterinarë të importuara ose të prodhuara në vend.

2. Biopreparatet janë vaksinat, serumet, diagnostikuesit, shtamet dhe përbërësit për prodhimin e tyre. Ato prodhohen nga institucione të autorizuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe përdoren pasi të jenë kontrolluar nga Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar.

Neni 77

Importimi, eksportimi dhe shitja e biopreparateve, e medikamenteve dhe e prodhimeve biologjike për kafshë lejohet vetëm në përputhje me nenin 40 pikat 1, 2, 3 dhe nenin 76 pika 2 të këtij ligji.

Neni 78

1. Komisioni i Kontrollit të Bioprodukteve dhe Medikamenteve Veterinarë ngrihet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit pranë Drejtorisë Veterinarë.

2. Në përbërje të Komisionit të Kontrollit të Bioprodukteve dhe Medikamenteve Veterinarë janë:

a) Drejtori i Drejtorisë Veterinarë në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, i cili është dhe Kryetar i Komisionit;

b) Drejtori i Institutit të Kërkimeve Veterinarë;

- c) Përgjegjësi i Laboratorit Shtetëror të Kontrollit Veterinar;
- ç) Përgjegjësi i Departamentit të Bakteriologjisë dhe Parazitologjisë;
- d) Përgjegjësi i Departamentit të Virologjisë;
- dh) specialist nga Drejtoria Veterinare.

KREU XVI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 79

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen si kundërvajtje administrative dhe dënohen me 50 000 lekë deri në 100 000 lekë:

- a) pronari ose kujdestari i kafshëve që vepron në kundërshtim me nenet 24, 25, 27 dhe 28 të këtij ligji;
- b) mjeku veterinar në rastet kur:
 - i) nuk zbaton masat e urdhëruara sipas nenit 30 të këtij ligji;
 - ii) lëshon certifikatën veterinare pavarësisht nga bllokimi;
 - iii) vepron në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2, 3 dhe 7 të nenit 45 të këtij ligji;
 - iv) vendos në treg materiale të papërpunuara ose produkte me origjinë shtazore në kundërshtim me bllokimin e tyre, sipas pikës 2 të nenit 46 të këtij ligji;
 - v) vepron në kundërshtim me nenin 47 të këtij ligji;
 - vi) nuk realizon dhe nuk zbaton ndonjë nga masat e urdhëruara për parandalimin e pasojave të dëmshme për shkak të mbetjeve të prodhimeve mjekësore ose të ndonjë subjekti tjetër të dëmshëm në materialet e papërpunuara, në produktet me origjinë shtazore dhe në produkte për kafshë;
 - vii) vepron në kundërshtim me nenin 57 të këtij ligji;
 - viii) nuk realizon masat e urdhëruara në zbatim të nenit 89 të këtij ligji;
- c) cilido që shkel nenin 20 të këtij ligji.

2. Kur nuk përbën vepër penale, konsiderohet si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 150 000 lekë cilido që:

- a) ngarkon, shkarkon, ringarkon, magazinon, përpunon një ngarkesë për eksport ose kur një ngarkesë ka qenë importuar në kundërshtim me pikën 2 të nenit 37 të këtij ligji;
- b) ringarkon ose magazinon në pikën e inspektimit veterinar kufitar pa inspektim dhe kontroll veterinar një ngarkesë për eksport, sipas pikës 1 të nenit 38 të këtij ligji;
- c) importon, tranziton ose magazinon një ngarkesë, pa leje nga administrata veterinare, sipas pikës 1 të nenit 39 të këtij ligji;
- ç) nuk mban në karantinë kafshën e importuar, ose gjatë karantinës nuk bën analizat e caktuara, sipas pikës 1 të nenit 42 të këtij ligji;
- d) ther njëthundrakë, dythundrakë, shpendë e lepuj për therje në një thertore që nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 4 të nenit 42 të këtij ligji;
- dh) importon, eksporton ose tranziton ngarkesa jashtë pikës së inspektimit veterinar kufitar të caktuar për këtë qëllim, sipas pikave 1 e 2 të nenit 43 të këtij ligji;
- e) importon, eksporton ose tranziton ngarkesa në kundërshtim me nenin 44 të këtij ligji;
- ë) prodhon, shet ose blen qumësht apo prodhime qumështi për konsum publik pa leje veterinare, sipas nenit 48 të këtij ligji;
- f) vepron në kundërshtim me nenin 50 të këtij ligji;
- g) eksporton materiale të papërpunuara, produkte me origjinë shtazore, peshk, vezë, shpendë për punë racore, vezë për shtrim (çelje) ose mallra të tjera, në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji;
- gj) vepron në kundërshtim me pika 1 dhe 2 të nenit 56 të këtij ligji;
- h) vepron në kundërshtim me nenin 57 të këtij ligji;
- i) tregton në treg lëkura gjedhi, dhensh, dhish të paanalizuara për antraks, sipas pikës 3 të nenit 54 të këtij ligji.

3. Kur nuk përbën vepër penale, konsiderohet si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 300 000 lekë cilido që fillon dhe ushtron veprimtarinë veterinare në kundërshtim me shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 20 të këtij ligji.

4. Kur nuk përbën vepër penale, konsiderohet si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 30 000 lekë cilido që:

a) nuk lajmëron në mënyrë korrekte të gjitha palët e interesuara në rast vatrash sëmundjeje ngjitëse, si dhe në të gjitha rastet kur rrezikohet shëndeti publik dhe shëndeti kafshëve, sipas nenit 27 të këtij ligji.

b) ngarkon kafshë ose produkte me origjinë shtazore në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji;

c) nuk pastron ose nuk dezinfekton mjetet e transportit për transportimin e ngarkesave nën kontrollin sanitaro-veterinar, pas shkarkimit ose para ngarkimit në rastet e përcaktuara nga autoritetet kompetente, sipas pikës 1 të nenit 34 të këtij ligji;

ç) nuk paraqet certifikatë veterinare ose dokumente të tjera me kërkesën e autoriteteve kompetente, sipas pikës 1 të nenit 36 të këtij ligji;

d) nuk lajmëron inspektorin veterinar të pikës së inspektimit kufitar ose sektorin veterinar në qark për mbërritjen e ngarkesës, sipas nenit 39 të këtij ligji;

dh) nuk lajmëron zyrën veterinare vendore ose të qarkut brenda periudhës kohore të përcaktuar ose nuk njofton fare për fillimin e prodhimit, sipas nenit 45 të këtij ligji;

e) nuk ther kafshët e sëmura ose të dëmtuara (të plagosura), kur është urdhëruar nga inspektori veterinar;

ë) vepron në kundërshtim me pikën 1 të nenit 51 të këtij ligji;

f) vepron në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji;

g) vepron në kundërshtim me nenet 54, 58, 59 dhe 60 të këtij ligji;

gj) nuk mban dokumentet për origjinën e lëkurëve të blera.

5. Kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen si kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë 25 000 lekë:

a) transportuesi që nuk lajmëron zyrën veterinare më të afërt për aksidentin rrugor;

b) inspektori që nuk i jep ndihmë veterinare, nuk zbaton masat ose kur një thertore nuk zbaton kushtet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 36 të këtij ligji;

c) cilido që kalon pa inspektim sanitaro-veterinar dhe kontroll nga inspektori veterinar i pikës së kalimit kufitar, sipas pikës 1 të nenit 40 të këtij ligji, produktet me origjinë shtazore ose materialet e papërpunuara, të magazinuara, të paketuara, të përpunuara apo të trajtuara në zonat ku nuk aplikohet taksa doganore (duty free) ose magazina.

Neni 80

Kur nuk përbën vepër penale, konsiderohet si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 20 000 lekë cilido që shkel pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 79 të këtij ligji.

Neni 81

Konsiderohet si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 50 000 lekë cilido që:

a) vepron në kundërshtim me nenin 17 të këtij ligji;

b) nuk paraqet certifikatën veterinare për kafshët që tregtohen;

c) organizon ekspozitë, grumbullim ose gara kafshësh apo shitje të organizuar kafshësh ose shitje produktesh me origjinë shtazore jashtë mjediseve të miratuara nga autoriteti kompetent, sipas nenit 35 të këtij ligji;

ç) nuk paraqet certifikatë veterinare për kafshët e gjahut ose nuk realizon masat profilaktike;

d) nuk lejon kontrollin veterinar, sipas neneve 17 dhe 45 të këtij ligji.

Neni 82

Në rast shkeljesh të neneve 37, 38, 39, 40, 44, 46, 47, 48, 51, 53, 56 dhe 57 të këtij ligji, përveç gjobës, mund të vendoset edhe masa e sekuestros mbi mjetet dhe mallrat e stabilimentit, si masë sigurie deri në shlyerjen e gjobës.

Neni 83

Për gjobot e vendosura nga Inspektorati Veterinar zbatohen dispozitat e ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 84

1. Për të marrë vendimet pas shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit krijohet Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative në fushën e veterinarisë. Ky është një komision i përhershëm pranë kësaj Ministrie.

2. Komisioni përbëhet nga 5 persona, një jurist dhe 4 specialistë të fushës së veterinarisë dhe merr vendime me shumicë votash, pas shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, sipas këtij ligji ose akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. Komisioni thërret, me njoftim paraprak, personat fajtorë për kryerjen e kundërvajtjes në bazë të procesverbalit. Procedura e gjykimit para Komisionit zhvillohet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 85

Për të parandaluar futjen dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në kafshë nga vendet e tjera, si dhe për t'i eliminuar ato në territorin e Republikës së Shqipërisë, Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit urdhëron:

a) në të gjitha pikat e kalimit kufitar të Republikës së Shqipërisë të ketë inspektim konstant veterinar, ndërsa në zonat kufitare të ndërmerren masa të veçanta të përcaktuara në këtë ligj;

b) kufizimin, ndalimin, importimet ose tranzitimin e ngarkesave të kafshëve të gjalla dhe të produkteve me origjinë prej tyre nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe lëvizjen e njerëzve në rast rreziku të hyrjes së sëmundjeve ngjitëse.

Neni 86

Në zbatim të këtij ligji, Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit:

a) nxjerr akte nënligjore për rregullimin e veprimtarisë veterinarë, duke i përshtatur dhe përafruar ato me legjislacionin e Bashkimit Europian;

b) kontribuon në realizimin e politikave veterinarë nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve veterinarë ndërkombëtare;

c) harton, në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë, masat parandaluese afatshkurtra dhe afatgjata për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve kundër zoonozave;

ç) vendos krijimin, përbërjen dhe funksionimin e një komisioni të përbashkët ekspertësh për zoonozat, si një autoritet këshillues, me rregullore të përbashkët me Ministrin e Shëndetësisë.

Neni 87

Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit përcakton me rregullore të veçantë kushtet sanitaro-veterinare që duhet të plotësojnë mjediset dhe pajisjet për manipulimin post mortem të kadavrave të kafshëve, kushtet sanitaro-veterinare që duhet të plotësojnë stabilimentet për mbledhjen e konfiskateve, mbeturinave shtazore dhe barnave të bioprodukteve veterinarë të pavlefshme, si dhe metodat e përpunimit dhe asgjësimit të tyre.

Neni 88

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 17, 18, 20, 21, 27, 28, 30, 37, 38, 42, 43, 49, 51, 58, 59, 61, 62, 63, 65, 68, 76 dhe 78 këtij ligji.

Neni 89

Ligji nr.7674, datë 23.2.1993 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”, me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Neni 90

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4407, datë 25.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM

Nr.165, datë 6.12.2004

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT (KKRT)**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të neneve 88 e 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Halil Lalaj zgjidhet në detyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

VENDIM
Nr.808, datë 5.11.12004

**PËR MBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E REZERVËS SË SIGURISË PËR NAFTËN, GAZIN
DHE NËNPRODUKTET E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1, 2, 7 dhe 9 pika 1, 2 e 3 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Krijimi dhe mbajtja e rezervës së sigurisë

1. Rafineritë e naftës, instalimet bregdetare dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të cilat janë pajisur me lejet përkatëse, janë të detyruara të mbajnë rezervë sigurie për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre, për mbulimin e nevojave të konsumit kombëtar në periudha krizash dhe situatash të jashtëzakonshme, brenda territorit të vendit.

2. Kategoritë e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, për të cilat do të mbahen rezerva sigurie, janë:

- kategoria 0 (a) naftë brut;
- kategoria I (a) gazi i lëngshëm i naftës;
- kategoria II (a, b) benzinë automjetesh, benzinë mjetesh të fluturimit ajror;
- kategoria III (a, c) gazoil (diesel), lëndë djegëse për mjetet e fluturimit ajror, reaktivë, (kerozene);
- kategoria IV (b) solar.

a) Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve përcakton sasinë e rezervës së sigurisë të nënprodukteve të sipërmendura, që duhet të mbahet nga rafineritë e naftës, instalimet bregdetare dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë, e cila llogaritet në bazë të të dhënave dhe rezultateve faktike të veprimtarisë së vitit të mëparshëm.

b) sasia e rezervës së sigurisë, për vitin pasardhës, përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, në fund të tremujorit të tretë të vitit në vijim.

3. Mënyra e depozitimit:

a) Depozitat, ku ruhet rezerva e sigurisë, duhet të jenë të certifikuara teknikisht dhe të vlerësohen si magazina doganore, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në Kodin Doganor dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij, sipas vlerësimit të autoritetit doganor.

b) Depozitimi i plotë ose i pjesshëm i sasisë së rezervës së sigurisë nga subjektet që kanë detyrimin për ta mbajtur këtë rezervë sigurie, mund të bëhet edhe me marrëveshje kontraktuale me një subjekt të tretë, të pajisur me leje tregtimi a leje koncesioni dhe që zotëron depozita të certifikuara teknikisht.

Marrëveshja për depozitimin e plotë ose të pjesshëm të sasisë së rezervës së sigurisë ndërmjet subjektit që është i detyruar të mbajë rezervë sigurie dhe një subjekti të tretë duhet të jetë ekskluzive dhe me afat jo më pak se një vit kalendarik, si dhe duhet të garantojë mundësinë e përdorimit në rast vështirësish të furnizimit të tregut me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre.

4. Rregullat teknike për ruajtjen e nënprodukteve në depozitat ku mbahet rezerva e sigurisë dhe mënyra e organizimit të kontrollit për vlerësimin standardit të cilësisë së nënprodukteve në këto depozita, përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

5. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet, brenda muajit janar të çdo viti, i paraqet Këshillit të Ministrave një raport përmbledhës statistikor për rezervat e sigurisë, që do të mbahen për vitin në vazhdim, të llogaritura sipas përcaktimeve të pikave 2 e 3 më sipër.

II. Menaxhimi i krizës së furnizimit me naftë, gaz dhe me nënproduktet e tyre

1. Përdorimi i rezervave të sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre të jetë si më poshtë vijon:

a) rezervat e sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre mund të përdoren vetëm në situatë emergjence, duke përcaktuar detyruesisht datën e zëvendësimit të rezervave të përdorura;

b) përdorimi i rezervave të sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre përfshin shitjen, dhënien hua ose transferimin e së drejtës së administrimit ekonomik;

c) propozimi për përdorimin e rezervave të sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre të paraqitet pranë Kryeministrit, nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

2. Vlerësohet situatë emergjente kur tregu hidrokarbur karakterizohet nga reduktimi i përshpejtuar, deri në mungesë, i furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, nga rritja e ndjeshme e çmimit të tyre në treg dhe zvogëlimi, në mënyrë të ndjeshme, i importeve mesatare mujore të naftës brut dhe të nënprodukteve hidrokarbure, në krahasim me importet mesatare mujore të vitit kalendarik pararendës, ose kur ky zvogëlim parashikohet në mënyrë të argumentuar në një shkallë të tillë që pasojat e pafavorshme të shkaktuara nga kjo situatë nuk mund të shmangen a të parandalohen pa përcaktimin e masave, në përputhje me këtë vendim.

Në rast krize apo situatë emergjente në furnizimin e tregut vendas me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, Kryeministri shpall, me urdhër, gjendjen e emergjencës për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre.

3. Me shpalljen e gjendjes së emergjencës, nën kryesinë e Kryeministrit, mbledhet Komiteti i Menaxhimit të Krizës.

4. Komiteti i Menaxhimit të Krizës ka anëtarë ministrin përgjegjës për Hidrokarburet, Ministrin Përgjegjës për Transportet, Ministrin e Financave, Ministrin e Ekonomisë, Ministrin Përgjegjës për Pushtetin Vendor, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Rendit Publik, Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Hidrokarbureve, Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Tokësor, si dhe nga një përfaqësues për çdo rafineri të përpunimit të naftës dhe dy përfaqësues të shoqatës së hidrokarbureve.

Në mbledhjet e Komitetit të Menaxhimit të Krizës marrin pjesë si të ftuar edhe specialistë nga ministrinë e përmendura në pikën 4 të këtij vendimi. Kryetari i sindikatës që vepron në sektorin e hidrokarbureve ose dy kryetarët e sindikatave më të mëdha që veprojnë në këtë sektor.

5. Komiteti merr vendime me shumicë votash. Në rastet kur votat janë të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.

6. Në rast të shuarjes së shkaqeve për të cilat është shpallur gjendja emergjente për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre, me urdhër të veçantë të Kryeministrit, pas propozimit të ministrit përgjegjës për hidrokarbure, revokohet kjo gjendje.

Shpallja dhe revokimi i gjendjes emergjente për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre njoftohet në media.

7. Komiteti i Menaxhimit të Krizës përcakton mënyrën e përdorimit të rezervës së sigurisë dhe çmimin e hedhjes në treg të kësaj rezerve. Forma e pagesës për subjektet që ruajnë rezervën e sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi nga vetë subjektet dhe nga organet e institucionet shtetërore, që e marrin këtë rezervë.

8. Detyrat e Komitetit të Menaxhimit të Krizës janë:

a) hartimi dhe miratimi i programit për masat organizative të sigurisë, të cilat garantojnë zbutjen dhe administrimin e efekteve të krizës për furnizimin me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, deri në daljen nga kriza.

Masat që duhet të përfshihen në këtë program kanë të bëjnë me kufizimin:

- e shpejtësisë maksimale të mjeteve motorike në qarkullimin rrugor;

- e përdorimit të disa tipeve, kategorive dhe llojeve të mjeteve motorike gjatë ditëve të caktuara ose për lloje specifike të transportit;

- ose ndalimin e përdorimit, gjatë ditëve të caktuara, të disa grupeve të mjeteve motorike me numër fundor të targës çift ose tek;

- e përdorimit të mjeteve motorike hekurudhore;
- e biznesit të transportit ajror, i cili mund të fillojë të zbatohet pas 30 ditëve nga njoftimi për këtë kufizim;

- e orëve të punës së stacioneve të shitjes së karburanteve;
- ose futjen e sistemit të racionimit apo të ndalimit përkohësisht të eksportit të naftës brut dhe të nënprodukteve hidrokarbure.

Në program mund të parashikohen edhe masa të tjera organizative ose shtrënguese, në bazë të situatave dhe të problemeve konkrete, që kërkojnë zgjidhje.

b) kërkesa ndaj ministrit përgjegjës për hidrokarburet, i cili, gjatë periudhës së emergjencës, të ushtrojë kontroll për zbatimin e detyrimeve për mbajtjen e rezervës së sigurisë.

9. Gjatë situatës emergjente për naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre dhe gjatë kohës kur konsumi dhe furnizimi mesatar mujor i naftës brut dhe nënprodukteve hidrokarbure në vend zvogëlohen me më shumë se 15 për qind në krahasim me konsumin dhe furnizimin mesatar mujor të vitit kalendarik pararendës, shoqëritë e importimit dhe të tregtimit të naftës brut dhe të nënprodukteve hidrokarbure janë të detyruara t'i japin ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, sipas kërkesës dhe brenda kufijve kohorë të përcaktuara nga ajo, të dhëna për importet e këtyre produkteve, eksportet, rezervat e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre, dhe për çmimet e shitjes.

III. Vendimi nr.116, datë 18.3.1999 i Këshillit të Ministrave, për rezervën e sigurisë së naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, shfuqizohet.

IV. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Financave, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Ministri i Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.809, datë 26.11.2004

PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË SISTEMIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, NË PRONËSI TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10 pika 3.I shkronjat “a” dhe “b”, 72 pika 5.I shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe të neneve 3 shkronja “e”, 4, 6 shkronjat “a” e 16 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2002 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1, 2 e 3 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen pronat e paluajtshme të sistemeve përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve, të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit dhe të koncesionit, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, ndërmarrjeve të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësive të qeverisjes vendore me donatorët e huaj dhe shoqëritë kontraktuese.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përfitojnë prona sipas lidhjeve 1, 2 e 3 të këtij vendimi, janë të detyruara të ruajnë statusin juridik si shoqëri anonime, të paktën për një periudhë 2-vjeçare.

4. Ministria e Ekonomisë të pasqyrojë ndryshimet e kapitaleve, që vijnë si rezultat i transferimit të pronave të paluajtshme në njësitë e qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 2 dhe 3. Forma e administrimit të sistemeve që transferohen të përcaktohet nga njësitë e qeverisjes vendore.

5. Zyrtat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore të kryejnë procedurat e regjistrimit të këtyre pronave, të miratuara me këtë vendim.

6. Detyrimet financiare të prapambetura, deri në çastin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore, të rregullohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

7. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, të transferojnë në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, me destinacion subvencionet dhe investimet buxhetore për pronat e transferuara, duke iu referuar buxheteve përkatëse të viteve të mëparshme dhe akteve ligjore në fuqi.

8. Ministrat dhe drejtuesit e institucioneve qendrore përkatëse të hartojnë udhëzimet e përbashkëta në zbatim të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe donatorët e huaj, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA 1

NDËRMARRJE TË UJËSJELLËSVE DHE KANALIZIMEVE, PRONAT E PALUAJTSHME SHTETËRORE TË TË CILAVE TRANSFEROHEN PLOTËSISHT

Nr.	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësia e qeverisjes vendore në të cilën transferohen	Referenca e miratimit të listave të inventarëve	
				VKM nr. dt.	Lista nr.
1	Ujësjellësi Divjakë	Ndërm.	Bashkia Divjakë	643 18.9.2003	2

LIDHJA 2

NDËRMARRJE TË UJËSJELLËSVE DHE TË KANALIZIMEVE, PRONAT E PALUAJTSHME SHTETËRORE TË TË CILAVE TRANSFEROHEN PLOTËSISHT SIPAS SISTEMEVE PËRBËRËS

Nr	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësitë e qeverisjes vendore në të cilat transferohen	Nr.e sistemeve që transferohen	Referenca e miratim.invent.
1	Ujësjellës-kanalizime Pukë	sh.a.	Komuna Fierzë	Sist. 2,16,21,22	VKM 251 24.4.2003 lista11
2	Ujësjellës-kanalizime Pukë	sh.a.	Komuna Qerret	Sist. 23,24,26,27,28	VKM 251 24.4.2003 lista 11

3	Ujësjiellës-kanalizime Pukë	sh.a.	Komuna Iballë	Sist. 18,19,20,29	VKM 251 24.4.2003 lista 11
4	Ujësjiellës-kanalizime Delvinë	sh.a.	Komuna Vergo	Sist. 3	VKM 366 5.6.2003 lista 3
5	Ujësjiellësi Shkodër fshat	Ndërm.	Komuna Guri i Zi	Sist. 6,8	VKM 366 5.6.2003 lista 4
6	Ujësjiellësi Shkodër fshat	Ndërm.	Komuna Ana e Malit	Sist. 10	VKM 366 5.6.2003 lista 4
7	Ujësjiellësi Gjirokastrë fshat	Ndërm.	Komuna Lazarat	Sist. 4,7	VKM 366 5.6.2003 lista 14
8	Ujësjiellësi Gjirokastrë fshat	Ndërm.	Komuna Dropull i Sipërm	Sist. 9	VKM 366 5.6.2003 lista 14
9	Ujësjiellësi Gjirokastrë fshat	Ndërm.	Komuna Odrie	Sist. 11,14,15	VKM 366 5.6.2003 lista 14
10	Ujësjiellësi Gjirokastrë fshat	Ndërm.	Komuna Picar	Sist. 17,18	VKM 366 5.6.2003 lista 14
11	Ujësjiellësi Kurbin	sh.a.	Bashkia Laç	Sist. 1	VKM 643 18.9.2003 lista 4
12	Ujësjiellësi Kurbin	sh.a.	Komuna Milot	Sist. 5	VKM 643 18.9.2003 lista 4

LIDHJA 3

NDËRMARRJE TË UJËSJIELLËSVE DHE TË KANALIZIMEVE, PRONAT E PALUAJTSHME SHTETËRORE TË TË CILAVE TRANSFEROHEN VETËM PËR SISTEMET PËRBËRËSE TË IDENTIFIKUARA

Nr.	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësitë e qeverisjes vendore në të cilat transferohen	Nr.e sistemeve që transferohen	Referenca e miratim.invent.
1	Ujësjiellësi Gramsh	sh.a.	Komuna Kodovjat	Sist. 2,4	VKM 251 24.4.2003 lista3
2	Ujësjiellës-kanalizime Kuçovë	sh.a.	Komuna Kozarë	Sist. 5,6,7	VKM 251 24.4.2003 lista 5
3	Ujësjiellësi Skrapar	sh.a.	Komuna Potom	Sist.7,8	VKM 251 24.4.2003 lista 13
4	Ujësjiellësi Skrapar	sh.a.	Komuna Çepan	Sist. 9,10,11	VKM 251 24.4.2003 lista 13
5	Ujësjiellësi Vlorë	sh.a.	Bashkia Himarë	Sist. 2	VKM 251 24.4.2003 lista 16

6	Ujësjiellësi Vlorë	sh.a.	Bashkia Orikum	Sist. 8,9	VKM 251 24.4.2003 lista 16
7	Ujësjiellës Vlorë	sh.a.	Komuna Shushicë	Sist. 6	VKM 251 24.4.2003 lista 16
8	Ujësjiellësi Vlorë	sh.a.	Komuna Novoselë	Sist.7	VKM 251 24.4.2003 lista 16
9	Ujësjiellësi Vlorë	sh.a.	Komuna Armen	Sist. 10,11	VKM 251 24.4.2003 lista 16
10	Ujësjiellësi Elbasan fshat	sh.a.	Komuna Fierzë	Sist. 5,7	VKM 366 5.6.2003 lista 5
11	Ujësjiellësi Elbasan fshat	sh.a.	Bashkia Grekan	Sist. 6	VKM 366 5.6.2003 lista 5
12	Ujësjiellësi Elbasan fshat	sh.a.	Komuna Gostimë	Sist.12,13,14	VKM 366 5.6.2003 lista 5
13	Ujësjiellësi Elbasan fshat	sh.a.	Komuna Papër	Sist.15,16,18	VKM 366 5.6.2003 lista 5
14	Ujësjiellësi Elbasan fshat	sh.a.	Komuna Labinot Fushë	Sist.28	VKM 366 5.6.2003 lista 5
15	Ujësjiellësi Elbasan fshat	sh.a.	Komuna Labinot Mal	Sist. 23	VKM 366 5.6.2003 lista 5
16	Ujësjiellësi Lushnjë fshat	sh.a.	Komuna Allkaj	Sist. 2	VKM 366 5.6.2003 lista 12
17	Ujësjiellësi Lushnjë fshat	sh.a.	Komuna Gradishtë	Sist. 6	VKM 366 5.6.2003 lista 12
18	Ujësjiellësi Korçë fshat	sh.a.	Komuna Voskop	Sist. 4	VKM 643 18.9.2003 lista 9
19	Ujësjiellësi Korçë fshat	sh.a.	Komuna Libonik	Sist. 6,7,8,9	VKM 643 18.9.2003 lista 9
20	Ujësjiellësi Korçë fshat	sh.a.	Komuna Vreshtas	Sist. 10,11,12,13	VKM 643 18.9.2003 lista 9
21	Ujësjiellës-Kanalizime Fier	sh.a.	Komuna Levan	Sist. 7,8	VKM 643 18.9.2003 lista 13

VENDIM
Nr.814, datë 3.12.2004

PËR NORMAT E STREHIMIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 17 e 18 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, me propozimin e Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit, përfshijnë:

- a) sipërfaqen minimale të banimit që i takon një personi;
- b) numrin e personave për çdo dhomë të banuar.

2. Sipërfaqja minimale e banimit, që i takon një personi të vetëm, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, është 12.5 m². Çdo personi tjetër shtesë mbi të parin, me moshë mbi 10 vjeç, i takon 7.5 m² sipërfaqe banimi, ndërsa çdo personi tjetër shtesë me moshë nga 5 vjeç deri në 10 vjeç i takon 3.75 m² sipërfaqe banimi.

Fëmijët nën moshën 5 vjeç nuk llogariten për efekt të përfitimit të sipërfaqes së banimit.

Kur blihen apartamente në treg, për t’u përdorur si banesa sociale me qira ose si banesa me kosto të ulët, sipërfaqja që i takon çdo personi shtesë mbi të parin mund të rritet deri në masën 15 për qind për strukturën e apartamentit që i takon familjes, sipas pikës 5 të këtij vendimi. Familjet që do të trajtohen me banesa me kosto të ulët, të blera në treg me norma më të larta se ato të përcaktuara në këtë pikë, të paguajnë, në mënyrë të menjëhershme, diferencën e koston së sipërfaqes së tepërt, sipas udhëzimit të Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

3. Individët me aftësi të kufizuar, të deklaruar nga komisionet përkatëse, që trajtohen sipas shkronjës “d” të nenit 5 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, të cilët kanë nevojë për përkujdesje, sipas ligjeve përkatëse, ku trajtohet statusi i tyre, përfitojnë 12.5m² sipërfaqe banimi, e cila të jetë dhomë më vete.

4. Përfitojnë dhomë më vete fëmijët me moshë mbi 10 vjeç, të sekseve të ndryshme.

5. Numri i personave për dhomë të banuar dhe sipërfaqet korresponduese përcaktohen në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Normat e projektimit për sipërfaqet e banimit, të parashikuara në vendimin nr.567, datë 6.12.1993 të Këshillit të Ministrave “Për normat e projektimit të banesave”, nuk zbatohen për banesat që përdoren për programet sociale të strehimit.

7. Vendimi nr.113, datë 20.1.1997 i Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit në banesat që ndërtohen me fondet publike”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen bashkitë dhe të gjitha institucionet, që sigurojnë banesa sociale me qira ose banesa me kosto të ulët, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Tabela

Struktura e apartamentit	Garsoniere		1+1		2+1		3+1	
Nr. i personave/apartament	Min.1	Max..2	Min.2	Max.3	Min.3	Max.4	Min.4	Max.6
Sipërfaqja e banimit (m ²)	12.5	20-21	20-21	27,5-29,75	27,5-29,5	35-38	35-38	50-56

VENDIM
Nr.816, datë 3.12.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SUEDISË, PËR MBËSHTETJEN E PROJEKTIT TË SHËRBIMEVE EFIÇENTE TË PUNËSIMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë, për mbështetjen e projektit të shërbimeve eficientë të punësimit në Shqipëri, nënshkruar në Tiranë, më 27.10.2004.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
SPECIFIKE NDËRMJET QEVERISË SË SUEDISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR MBËSHTETJEN E PROJEKTIT TË SHËRBIMEVE EFIÇENTE TË PUNËSIMIT NË SHQIPËRI

Qeveria e Suedisë (më poshtë referuar si Suedia) dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si Shqipëria) kane rënë dakord për sa më poshtë:

Agjencia Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar, SIDA dhe autoriteti kompetent i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Shqipërisë do të kenë autoritetin për të përfaqësuar qeveritë e tyre në çështjet përkatëse lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1

Fusha dhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje

Shqipëria ka vendosur të realizojë një projekt të quajtur Shërbime Eficientë të Punësimit në Shqipëri.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është që të nxisë një funksionim më të mirë të tregut të punës në Shqipëri dhe rritjen e punësimit në vend, nëpërmjet ndihmës më eficientë dhe më efektive të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP).

Qëllimet, objektivat e projektit janë: të përmirësojë cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve publike të punësimit për punëdhënësit dhe punëkërkuessit në Shqipëri; të zhvillojë një sistem të ri të informacionit për menaxhimin e tregut të punës në SHKP si një bazë për nxitjen e menaxhimit sipas objektivave dhe rezultateve; nxitjen e një modeli të ri të trajnimit për stafin e SHKP-së, në mënyrë që të rriten kapacitetet e tij, si dhe të përmirësojë komunikimin dhe koordinimin si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit të SHKP-së me partnerët e tij.

Rezultatet që priten të realizohen janë:

- Shërbime publike të reja dhe efikente të punësimit, (SHPP-Shërbimet Publike të Punësimit) në dy rajone pilot të Shqipërisë me shërbime të përmirësuara dhe cilësore, që do t'i përshtaten kërkesës së tregut të punës. Rezultate të tjera janë koordinimi në rritje ndërmjet punëdhënësve, të cilët përdorin SHPP-në dhe që ndjehen të kënaqur me shërbimet e SHPP-së, me zhvillimin e një plani për zbatimin e sistemeve të testuara pilot në të gjithë Organizatën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;

- Një sistem i ri dhe efikent për menaxhimin e informacionit të tregut të punës dhe menaxhim sipas objektivave dhe rezultateve të ngritura (të formuara) në SHKP-në dhe në dy rajonet (zonat) pilot të përzgjedhura. Rezultate të tjera janë zhvillimi i një plani për zbatimin e të dy sistemeve në të gjithë Organizatën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP);

- Ngritja e një modeli të ri për trajnimin e stafit, veçanërisht duke u fokusuar në dy rajonet pilot të përzgjedhura. Rezultate të tjera janë menaxhimi i përmirësuar dhe aftësimi i stafit në zyrat qendrore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në qendrat rajonale të punësimit në dy zonat e përzgjedhura;

- Zhvillimi i një modeli të ri për komunikimin brenda dhe jashtë institucionit, si dhe një plan zhvillimi për përmbushjen e politikave të reja në të gjithë sistemin organizativ të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Projekti do të realizohet në përputhje me projektdokumentin e titulluar “Shërbimet efikente të punësimit në Shqipëri”, që mban datën 4 qershor 2004, si dhe ndryshimeve të mëvonshme. Do të ketë edhe aktivitete të veçanta, si dhe termat e referencës për monitorimin e projektit nëpërmjet shërbimeve të një grupi të kualifikuar, që do të prokurohet (përzgjidhet) nga Suedia.

Neni 2

Kontributi suedez

Suedia do të mbështesë zbatimin dhe monitorimin e projektit dhe të një grupi të kualifikuar siç specifikohet në këtë Marrëveshje me një shumë prej katërmëdhjetë milionë korona suedeze (14 000 000 sek).

Neni 3

Detyrimet e Palës shqiptare

Shqipëria merr përsipër:

- Të përmbushë projektin dhe të mundësojë burimet siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje, veçanërisht të mundësojë burimet dhe mbulimin e kostos përkatëse si vijon:

- Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale (Ministria) duhet të caktojë një anëtar të një niveli të lartë për të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e Komitetit Drejtues të Projektit, i cili do të ngrihet për përmbushjen e këtij projekti;

- Ministria dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) do të mundësojnë alokimin e një buxheti të nevojshëm për Taksën mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) lidhur me investimet e këtij projekti në një vlerë maksimale prej 160 000 euro (njëqind e gjashtëdhjetë mijë euro);

- Një kordinator lokal projekti, shumë i kualifikuar, do të caktohet (për të punuar me 80% kohë pune për këtë projekt) nga SHKP-ja, për të filluar nga puna nga fundi i tetorit 2004; Ky person do të jetë përgjegjës për planet ditore, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve dhe grupit shqiptar të punës në këtë projekt dhe për koordinimin me dhe mbështetjen e drejtuesit suedez të projektit, si dhe të ekspertëve që do të punojnë me këtë projekt;

- Ministria dhe SHKP-ja duhet të garantojnë përgjithësisht një staf të mirë për projektin, si dhe pjesëmarrje të aktorëve në aktivitetet trajnuese. Për secilin nga komponentët kryesorë të projektit (katër komponentë), një drejtues për komponent do të zgjidhet nga stafi i SHKP-së. Këta drejtues pritet që t'i kushtojnë një kohë të mjaftueshme aktiviteteve të këtij projekti;

- SHKP-ja duhet të mundësojë shërbime të nevojshme dhe mbështetje për të mundësuar mbarëvajtjen e projektit dhe stafi shqiptar duhet të marrë pjesë në aktivitetet e projektit, të tilla si:

i) Hapësira për t'u përdorur për zyra për projektin dhe pajisje për zyra në selinë qendrore të SHKP-së, përfshirë edhe koston telefonike;

ii) Sekretari, shërbime të përkthimit me shkrim e me gojë për të gjitha dokumentet e prodhuara brenda, si dhe përkthimi gjatë mbledhjeve të brendshme do të sigurohet nga SHKP-ja. Suedia do të mbulojë vetëm koston e dokumenteve të prodhuara jashtë dhe koston e përkthimit në konferenca;

iii) Transporti lokal, akomodimi dhe ushqimi në rastet e konferencave etj. për stafin shqiptar, kur marrin pjesë në aktivitetet e projektit dhe në trajnime siç edhe kërkohet nga SHKP-ja, do të mbulohen nga vetë ai, d.m.th. SHKP-ja. Suedia do të financojë koston e transportit dhe të akomodimit për stafin ndërkombëtar të projektit.

Neni 4

Kushtet për kontributin suedez

1. Vetëm kostoja për aktivitetet që do të realizohen gjatë periudhës nga fillimi deri në 30 nëntor të 2006 mund të financohet nga kontributi suedez. Projekti do të mund të fillojë vetëm pasi të firmoset kjo Marrëveshje nga ana e Palës suedeze dhe Palës shqiptare pas plotësimit të procedurave të nevojshme nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Nëse Marrëveshja nuk do të firmoset deri më 31 tetor të vitit 2004 atëherë projekti nuk do të fillojë.

2. Pas një periudhe prej 6 muajsh nga data e përmendur, kontributi në këtë Marrëveshje nuk do të jetë i mundshëm për t'u disbursuar. Nëse aktivitetet pas datës së 30 nëntorit të 2006 nuk janë financuar sipas një marrëveshjeje të re, personeli mund të financohet nga kjo Marrëveshje, për periudhën e shënuar në kontratat individuale të punës, për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, me kusht që autoritetet përgjegjëse të kenë rënë dakord për periudhën e punësimit ose të zgjatjes së kontratës për periudhën e punësimit përtej datës së fundit të përmendur më sipër.

3. Suedia mundet që në çdo kohë, të ndërpresë projektin ose punën e konsulentëve nëse ndodhin shmangie nga plani ose nga buxheti për të cilin është rënë dakord më parë; nëse vihet re keqpërdorimi i fondeve ose burimeve të tjera: nëse burimet që do të alokohen nga përfituesi nuk janë dhënë sipas planifikimit; nëse objektivat e projektit janë të rrezikuara; nëse raportet nuk dorëzohen siç është rënë dakord; nëse menaxhimi financiar i projektit nuk është i kënaqshëm: ose nëse projekti nuk zhvillohet në mënyrë të favorshme përsa i përket objektivave dhe çdo aspekti tjetër të rëndësishëm të tij.

4. Kushte të rëndësishme specifike të projektit. Projekti do të mund të fillojë vetëm me firmosjen e kësaj Marrëveshjeje. Nëse Marrëveshja nuk do të jetë firmosur deri më 31 tetor 2004 dhe nuk do të jetë caktuar një koordinator lokal projekti nga SHKP-ja deri në këtë datë, atëherë projekti nuk do të fillojë. Për më tepër, në qoftë se detyrimet e Shqipërisë, të përmendura në nenin 3, nuk janë realizuar në afatet e duhura kohore, Suedia mund të ndërpresë projektin dhe punën e konsulentëve. Nëse do të ndodhë kështu, Suedia sipas opsioneve të lindura (sipas dëshirës), mund të zgjidhë këtë Marrëveshje, duke dhënë një njoftim me shkrim një muaj përpara, ose në një datë të tillë që Suedia bie dakord, (duke iu referuar gjithashtu nenit 11).

Neni 5

Prokurimi

Asnjë ofertë, dhuratë ose pagesë, konsideratë ose përfitim i çdo lloji, që mund të vihet re si një praktikë abuzive/korruptive ose e paligjshme, nuk duhet të pranohet as drejtpërdrejt ose tërthorazi, si një shpërblim ose si stimul për zbatimin e kontratave të financuara brenda projektit.

Suedia mund të prokurojë ose detyrojë të prokurohen të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet brenda këtij projekti.

Mallrat e prokuruar nga Suedia sipas kësaj Marrëveshjeje për t'u përdorur nga konsulentët, mbeten pasuri e Suedisë pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk është rënë dakord për një formë tjetër.

Neni 6

Raportimi dhe procedurat e tjera të zbatimit të projektit

Palët do të mbajnë mbledhje të rregullta pune për të shqyrtuar, planifikuar dhe ndjekur ecurinë e projektit çdo gjashtëmujor. Një nga këto mbledhje do të përbëjë edhe mbledhjen e rregullt vjetore. Raportet e mbledhjes do të firmohen për çdo mbledhje.

Një draft i raportit vjetor progresit do t'i paraqitet Suedisë nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit para mbajtjes së mbledhjes së rregullt vjetore dhe jo më vonë se data 1 maj e viteve 2005 dhe 2006. Mbledhja e rregullt vjetore mund të vendosë se ky raport duhet të ndryshohet dhe në këtë rast duhet të caktohet një datë për raportin përfundimtar në protokollin e mbledhjes.

Pavarësisht nga rënia dakord për kohën e raportimit, palët duhet të informojnë në mënyrë të shpejtë njëra-tjetrën nëse ndodh një situatë që e bën projektin të mos realizohet siç edhe është rënë dakord.

Neni 7

Disbursimi

Suedia do të bëjë pagesa të drejtpërdrejta konsulentëve për shërbimet dhe prokurimet. Përfituesi do të kontrollojë dhe miratojë të gjitha faturat për shërbimet dhe prokurimet.

Neni 8

Delegimi i pushtetit

Suedia, nëpërmjet Agjencisë së saj për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar, SIDA dhe Shqipëria, nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale të Republikës së Shqipërisë, do të kenë autoritetin për të përfaqësuar qeveritë e tyre në çështjet që kanë të bëjnë me përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Lidhja me marrëveshjet e tjera

Bashkëpunimi midis palëve sipas kësaj Marrëveshjeje rregullohet gjithashtu nga:

- "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Suedisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi termat dhe kushtet e përgjithshme për zhvillim dhe bashkëpunim" për periudhën 5 prill 2001-31 dhjetor 2005; dhe

- çdo marrëveshje që mund të amendojë ose zëvendësojë marrëveshjet në fjalë.

Neni 10

Shpërndarja e kësaj Marrëveshjeje

Palët marrin përsipër të shpërndajnë kopje të kësaj Marrëveshjeje për të gjitha ministrinë e tyre, autoritetet dhe institucionet e tjera të përfshira në projektin e bashkëpunimit ose që kanë nevojë për informacion mbi përmbajtjen e saj.

Neni 11
Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme deri më 30 qershor 2006 nëse nuk përfundon më parë përmes një njoftimi me shkrim të bërë tre muaj para kësaj kohe.

Në rast shkeljeje të neneve 3 dhe/ose 4, Suedia mund ta përfundojë Marrëveshjen duke bërë një njoftim një muaj para.

Në rast shkeljeje serioze të Marrëveshjes, Suedia mund ta përfundojë/tërhiqet nga Marrëveshja në mënyrë të menjëhershme.

Në rast të përfundimit të Marrëveshjes nga Shqipëria, asnjë fond nuk do të jepet për aktivitet pas skadimit të Marrëveshjes.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Pala suedeze dhe njoftimit nga Paala shqiptare, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të datës së hyrjes në fuqi të saj pas plotësimit të procedurave të brendshme.

Dy origjinale të tekstit të kësaj Marrëveshjeje, secili në gjuhët angleze dhe shqipe, janë firmosur. Për çdo mospërputhje midis teksteve në anglisht dhe shqip, teksti në anglisht ka përparësi.

Tiranë, 27.10.2004

SHPLLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i rrugës së varrezave të reja në qytetin e Shijakut”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është bashkia Shijak. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person, sipas listës emërore të mëposhtme.

**PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS SË VARREZAVE TË
REJA NË QYTETIN E SHIJAKUT**

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
1	Sali Keçi	153. 6 m ²	1 000	153 600
2	Pëllumb Keçi	130. 6 m ²	1 000	130 600
3	Artan Keçi	63 m ²	1 000	63 000
4	Asllan Keçi	176. 4 m ²	1 000	176 400

Vlera totale e shpronësimit është 523 600 lekë.

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Shijakut”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Shijak. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person, sipas listës emërore të mëposhtme.

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË QYTETIN E SHIJAKUT

Nr.	Emri mbiemri	Sip/tokë are	Çmimi i tokës/m ²	Vlera në total (lekë)
1	Asllan Ibrahim Keçi	4 950 m ²	1 000 lekë	4 950 000

Gjithsej vlera totale e shpronësimit 4 950 000 lekë.

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurisë të paluajtshme, pronë private (tokë truall) për ndërtimin e varrezave publike në qytetin e Kukësit.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Kukës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personin i cili preket nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për pronarin, sipas listës emërore të mëposhtme.

PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË QYTETIN E KUKËSIT

Nr.	Emri mbiemri	Sip/toke truall	Çmimi objektit/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)
1	Hazir Qazim Zenelaj	9665 m ²	1159.1	11 202 702

Vlera totale e shpronësimit është 11 202 702 lekë.

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i varrezave publike të bashkisë Kamëz”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Kamëz. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person, sipas listës emërore të mëposhtme.

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË BASHKISË KAMËZ

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
1	Hysen Adem Duro	500 m ²	1500	750 000
2	Gëzim Adem Duro	500 m ²	1500	750 000
3	Adem Hysen Duro	1300 m ²	1500	1 950 000
4	Fevri Nexhip Cucka	1700 m ²	1500	2 550 000

Vlera totale për këtë shpronësim është 6 000 000 lekë.

SHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i ujësjellësit të ri të qytetit të Gjirokastrës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është ndërmarrja ujësjellës-kanalizimeve, Gjirokastrë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person, sipas listës emërore të mëposhtme.

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT TË RI TË QYTETIT TË GJIROKASTRËS

1. Bashkëpronarët që shpronësohen për ndërtimin e rezervuarit të ujit Dunavati i Parë

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë për m ²	Vlera në lekë
1	Veliko Qazim Tuqi	440 m ²	1 583	696 520
2	Zakie Rakip Tuqi	440 m ²	1 583	696 520
3	Bahani Rakip Tuqi	440 m ²	1 583	696 520
4	Parime Qazim Tuqi	440 m ²	1 583	696 520
5	Enise Qazim Tuqi	440 m ²	1 583	696 520

2. Bashkëpronarët që shpronësohen për ndërtimin e rezervuarit të ujit Manalat (Safat)

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë për m ²	Vlera në lekë
1	Ali Servet Selfo	950 m ²	1583	1 503 850
2	Dashamir Servet Selfo	950 m ²	1583	1 503 850
3	Pranvera Servet Selfo (Beqiri)	950 m ²	1583	1 503 850
4	Zenejbi Servet Selfo (Malaj)	950 m ²	1583	1 503 850
5	Samet Hoxha	950 m ²	1583	1 503 850
6	Tomor Hoxha	950 m ²	1583	1 503 850
7	Luan Hoxha	950 m ²	1583	1 503 850
8	Alie Shalësi	950 m ²	1583	1 503 850

3. Bashkëpronarët që shpronësohen për ndërtimin e godinës administrative të sh.a. Gjirokastrër

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë për m ²	Vlera në lekë
1	Ymer Muharrem Gega	619 m ²	1 333	825 127
2	Dashamir Muharrem Gega	619 m ²	1 333	825 127
3	Lida Muharrem Gega	619 m ²	1 333	825 127
4	Perlat Muharrem Gega	619 m ²	1 333	825 127
5	Roland Muharrem Gega	619 m ²	1 333	825 127

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimi i ujësjellësit të ri në qytetin e Korçës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Sh.A. ujësjellës Korçë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person, sipas listës emërore të mëposhtme.

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT TË RI TË QYTETIT TË KORÇËS

Nr.	Emri mbiemri	Sip/tokë arë	Çmimi i tokës/m ²	Vlera në total (lekë)
1	Klito Nikolla Fundo	750 m ²	8 400 lekë	6 300 000
2	Emil Nikolla Fundo	750 m ²	8 400 lekë	6 300 000
3	Elisaveta Nikolla Fundo	750 m ²	8 400 lekë	6 300 000

Gjithsej vlera totale e shpronësimit 6 300 000 lekë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 17.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë